

III. DEPARTAMENTI I KONTROLLIT TË INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE ME FINANCIME TË HUAJA

1. KONTROLL NË NJËSINË E KOORDINIMIT TË PROJEKTIT “RIMËKËMBJA DHE ZHVILLIMI I SISTEMIT SHËNDETËSOR” NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË.

Në zbatim të programit të kontrollit nr. 736/1, 15.9.2006, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u ushtrua kontroll në Njësinë e Koordinimit të Projektit “Rimëkëmbja dhe Zhvillimi i Sistemit Shëndetësor” në Ministrinë e Shëndetësisë, me objekt kontrolli: “Mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare”.

Kontrolli u krye nga data 20.9.2006 deri më datën 15.11.2006, sipas drejtimeve të përcaktuara në këtë program kontrolli për gjithë periudhën e zbatimit të projektit.

Kontrolli u krye për zbatimin e ligjshmërisë, të rregullshmërisë financiare dhe vlerësimin e zbatimit të projektit.

Nga kontrolli i ushtruar rezultoi:

Mbi marrëveshjen financiare të kredisë së Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA).

Pas një sërë negociatash të filluara në pranverën e vitit 1997 është rënë dakort në parim me Bankën Botërore për nënshkrimin e një marrëveshje kredisë për rehabilitimin dhe rimëkëmbjen e sistemit shëndetësor. Vlera totale e Projektit të Rimëkëmbjes dhe Zhvillimit të Sistemit Shëndetësor është parashikuar 28 milionë USD, nga të cilat: 17 milionë USD financohen nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA-Banka Botërore), 8.6 milionë nga Donatore të tjerë, dhe 2.4 milionë USD nga Qeveria Shqiptare.

Marrëveshja e kredisë u konkretizua me miratimin në parim, me vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 226, datë 04.4.1998 dhe u miratua në Kuvendin e Shqipërisë me ligjin nr. 8380, datë 29.7.1998 “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA), për projektin e rimëkëmbjes dhe të zhvillimit të sistemit shëndetësor”. Kredia është dhënë në masën 12.6 milionë SDR (ekuivalente me 17 milion USD) me terma të buta, sipas standarteve të IDA-s. Periudha e shlyerjes është për 40 vjet, me periudhë të lirë 10 vjet. Kohëzgjatja e projektit është për një periudhën katërvjeçare deri në 31.3.2003. Rikthimi i kredisë (pagesa e principialit) do të fillojë të shlyhet nga 15 gusht 2008 deri në 15 shkurt 2038. Përgjegjëse për marrjen, administrimin dhe kthimin e Kredisë është Qeveria Shqiptare (huamarresi), në emër të së cilës është nënshkruar marrëveshja e kredisë, e cila ka angazhuar Ministrinë e Shëndetësisë për zbatimin e projektit.

Projekti përfaqëson një radhë të caktuar veprimesh, të shoqëruara me kostot përkatëse, zbatimi i të cilave synon arritjen e këtyre objektivave të projektit:

- Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore në ndihmë dhe në efikasitet të sektorit shëndetësor;

- Përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit në shërbimet shëndetësore bazë;

Komponentet kryesore të projektit janë:

A. Ndërtimi i kapaciteteve kombëtare për reformën dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor.

B. Administrimi dhe menaxhimi i sistemit shëndetësor në Tiranë.

C. Ngritja dhe modernizimi i sistemit shëndetësor në Tiranë.

D. Menaxhimi i projektit.

Shpërndarja e kredisë sipas kategorive të shpenzimeve të miratuar me ligjin e mësipërm, në funksion të arritjes së objektivave të projektit paraqitet si më poshtë:

Nr.	Kategoria	Shuma e kredisë së alokuar (SDR)	% e shpenzimeve të financuara
1	Punët civile	5,800,000	90%
2	Mallrat	4,100,000	100% ¹
3	Shërbimet e konsulencës, bursat dhe trajnimet	1,400,000	100%
4	Kostot operative	75,000	8%
5	Te paalokuara	1,225,000	
	Totali	12,600,000	

Pranë Ministrisë së Shëndetësisë, në korrik 1998 është ngritur dhe ka funksionuar Njësia e Koordinimit të Projektit (PCU) e cila është marrë me menaxhimin dhe zbatimin e projektit.

Mbi shkallën e realizimit të kategorive të shpenzimeve dhe komponentëve të kredisë, të krahasuara me ato të percaktuara në marreveshjen e huadhënësit. Arritja e objektivave të projektit:

1. Realizimi shpenzimeve të kredise, të ndare sipas kategorise së shpenzimeve.

• Realizimi i shpenzimeve sipas kategorive, në funksion të çdo komponenti të projektit “Rimëkëmbja dhe zhvillimi i sistemit shëndetësor” deri në 31 dhjetor 2002, paraqitet si më poshtë:

1. Punimet civile.

Kjo kategori sipas ligjit të mësipërm është planifikuar 5,800,000 SDR. Bazuar në PAD (dokumenti i vlerësimit të projektit), së bashku me vlerën e rezervës shkon në vlerën 8 616 100 USD.

Në këtë kategori përfshihen këto punime:

• Rehabilitimi (rikonstruksioni) fizik i qendrave shëndetësore rurale dhe urbane, gjithsej 37 qendra dhe 3 poliklinika, me vlerë 2 390 700 USD;

• Ndërtimi i spitalit të sëmundjeve të brendshme në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me vlerë 6 043 900 USD;

• Rikonstruksione të tjera me vlerë 181 500 USD.

Deri në 31 dhjetor 2002 (3-muaj para mbylljes së projektit) janë realizuar 1 129 500 USD ose 13% e fondeve të planifikuara për këtë kategori dhe realizimi kundrejt totalit të kredisë është 6.6%. Kjo shumë është përdorur me këtë destinacion:

• Nga 37 qendra shëndetësore dhe poliklinika të planifikuara janë ndërtuar vetëm 16 prej tyre me vlerë totale 929 361 USD.

• Spitali i sëmundjeve të brendshme në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” nuk është ndërtuar.

• Janë kryer rikonstruksione të tjera në vlerën 200 139 USD.

Pjesën më të madhe të këtij mosrealizimi e zë ndërtimi i spitalit të sëmundjeve të brendshme në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me vlerë 6 043 900 USD. Ndërtimi i këtij spitali është pjesa më kryesore e kësaj kategorie, si dhe zë një vend të rëndësishëm në impaktin që do të sjellë aplikimi i kësaj kredie në sektorin shëndetësor e cila së bashku me vlerën e pajisjeve dhe konsulencë – supervizimi është në vlerën 11 750 000 USD ose afërsisht 70% e vlerës së kredisë. Por deri në përfundim të afatit të projektit të përcaktuar në marreveshjen e kredisë, spitali i sëmundjeve të brendshme nuk ka filluar së ndërtuari.

2. Mallrat.

Sipas ligjit janë planifikuar 4 100 000 SDR dhe së bashku me vlerën e rezervës shkon në vlerën 6 664 000 USD. Kjo kategori parashikon këto shërbime dhe blerje mallrash:

- shërbime inxhinierike dhe të arkitekturës në vlerën 514 600 USD;
- pajisje mjekësore në vlerën 5 308 000 USD;

- pajisje zyre dhe mjete transporti në vlerën 765 300 USD;
- mobilje orendi në vlerën 76 100 USD.

Në fakt deri në 31.12.2002 janë realizuar 1 717 813 USD ose 25.7% e fondeve të planifikuara për këtë kategori.

Kjo vlerë e realizuar është përdorur me këtë destinacion:

• Shpenzimet për shërbimet inxhinierike dhe të arkitekturës 84798 (te cilat kanë kaluar në kategoria të shpenzimeve të konsulencës dhe asistencës);

- Pajisjet mjekësore 1 139 534 USD;
- Pajisje zyre dhe mjete transporti 262 833 USD.
- Mobilje orendi 230.648 USD.

Mosrealizimi i kësaj kategorie shpenzimi lidhet direkt me mosndërtimin e spitalit të ri, pasi pjesën më të madhe të vlerës së kësaj kategorie e zë blerja e paisjeve për këtë spital.

3. Shërbimet e konsulencës, bursat dhe trajnimet.

Sipas ligjit të mësipërm janë planifikuar 1.400.000 SDR që së bashku me rezervën shkon në vlerën 1 645 200 USD dhe zë afërsisht 14% të totalit të kredisë. Në këtë zë përfshihen:

- Asistenca teknike për zhvillim politikash në vlerën 258 900 USD;
- Asistenca teknike për kapacitete ndërtuese në vlerën 443.900 USD;
- Asistencë në zbatimin e projektit në vlerën 565 000 USD;
- Trajnime jashtë vendit në vlerën 331 300 USD;
- Trajnime brenda vendit në vlerën 46 100 USD.

Në fakt deri në 31 dhjetor 2002 janë realizuar 1 107 135 USD ose 67,3% e fondeve të planifikuara për këtë kategori.

Ky realizim paraqitet me këtë destinacion:

- Asistenca teknike për zhvillim politikash në vlerën 328 340 USD;
- Asistenca teknike për kapacitete ndërtues dhe zbatim projekti në vlerën 277 922 USD;
- Trajnime jashtë vendit në vlerën 270.167 USD;
- Trajnime brenda vendit në vlerën 5 782 USD;
- Pagat e personelit të PCU në vlerën 224 924 USD;

4. Kostot operative, sipas ligjit të mësipërm janë planifikuar 75 000 SDR të cilat së bashku me rezervën e rezervës shkon në vlerën 119 500 USD. Në këtë zë përfshihen.

- Shërbimet për pajisje mjekësore në vlerën 88 900USD;
- Pajisje zyre në vlerën 3 900 USD;
- Mjete transporti 5 900 USD;
- Ndërtesat 18 900 USD;
- Pagat e personelit që do të punojë për zbatimin e projektit (sipas marrëveshjes përfundimtare);
- Shpenzime të tjera 1 900 USD.

Në fakt deri në 31.12.2002 janë realizuar 87 575 USD ose 73,2% e fondeve të planifikuara për këtë kategori.

Ky realizim paraqitet me këtë destinacion:

- Shërbimet pajisje mjekësore, mirëmbajtja, nuk ka;
- Pajisje zyre në vlerën 57 897 USD;
- Mjete transporti 26 900 USD;
- Ndërtesat 2 778 USD;
- Pagat e personelit që punon për zbatimin e projektit nuk janë paguar nga kjo kategori, por nga kategoria 3, shërbimet e konsulencës, bursat dhe trajnimet.

Pra deri në datën 31.12.2002, fondet e disbursuara dhe të përdorura janë në vlerën 4 042 023 USD përkatësisht për: punime civile në vlerën 1 129 500 USD, mallra në vlerën 1 717 813

USD, kosto operative në vlerën 87 575 USD konsulenca, asistenca teknike, bursa trajnime në vlerën 1 107 135 USD.

Siç shihet konsulenca teknike zë 67% të këtyre fondeve në një kohë që kjo kategori, në raport me vlerën totale të kredisë zë 14%. Pra, gjate kësaj periudhe e gjithë vlera e këtij zëri është shpenzuar duke lënë pothuajse komplet punimet civile (ndërtimin e spitalit, qendrat shëndetësore blerjen e pajisjeve), vetëm me 537 865 USD (1 645 000 - 1 107 135) per t'u mbuluar në të ardhmen me konsulencë-supervizim.

Vlen të theksohet se nga zëri "konsulencë teknike" janë përdorur 141 256 USD, për 5 bursa studimi master jashtë vendit, me afat 1-vjeçar në fushën e shëndetit publik. Përdorimi i kësaj shume nuk është eficient, pasi nga pesë nëpunës që kanë marë bursë studimi nga kredia vetëm një prej tyre është kthyer për të punuar në projekt, 3 kanë qendruar si emigrant në vendet ku kanë shkuar me studime dhe njëri nuk punon për projektin.

Tre muaj para mbylljes se projektit, kredia është disbursuar dhe përdorur në vlerën 4 042 023 USD nga 17 milionë USD ose 23,7% e fondit të kredisë. Pra, rezultojnë të padisbursuara përafërsisht 13 milionë USD ose 76% e fondit të kredisë.

Ndodhur para kësaj situate gjatë periudhës janar–mars 2003 filluan negociimet për shtyrjen e afatit dhe ndryshimin e komponentëve të marrëveshjes së kredisë. Me shkresën nr. 322, datë 03.3.2003, Ministria e Shëndetësisë i ka nisur për mendim disa ministrive projektvendimin për ndryshimin e komponentëve, kotegorive të shpenzimeve të kredisë si dhe shtyrjen e afatit të projektit.

Në relacionin bashkëlidhur shkresës për mosrealizimin e kredisë jepen komentet dhe justifikimet, si më poshtë:

- Nuk është arritur konsensusi në lidhje me Programin Mjekësor të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë.

- Ka vonesa në kompletimin e legjislacionit të Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës.

- Meqenëse aktivitetet nuk mund të përfundojnë dot brenda kohës zyrtare të mbylljes së projektit e cila është 31 mars 2003, prandaj kërkohet shtyrje projekti deri më 31 janar 2004.

Projekti i rikompozuar parashikon këto ndryshime:

- Ndërhyrje në Qendrën Spitalore Universitare:
- Anulimin e ndërtimit të spitalit te ri për sëmundjet e brendshme dhe rehabilitimi radikal të ndërtesës së Onkologjisë, pasi aktualisht është në kushte shumë të këqija.
- Ngritjen e qendrës biomedikale (ndërtim + pajisje);
- Blerjen e një pakete pajisjesh mjekësore për të gjithë spitalin;
- Përmirësimin e trafikut të QSUT;
- Rehabilitimin e qendrës historike të QSUT.

Për plotësimin e kushteve të projektit të rikompozuar do të financohen aktivitetet e mëposhtme:

- Asistencë teknike për strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- Konsulencë për vlerësimin e nevojave të komunitetit;
- Asistencë për buxhetet kombëtare të shëndetësisë;
- Asistencë për hartimin e buxhetit;
- Asistencë për përgatitjen e master planit për Autoritetin Rajonal Shëndetësor të Tiranës;
- Konsulencë për Strategjinë Kombëtare të HIV/AIDS.

Në këtë relacion, nga Njësia e Koordinimit të Projektit nuk janë përcaktuar vlerat analitike të parashikuara për çdo zë shpenzimi që duhen për të arritur objektivat me ndryshimet e paraqitura.

Ne anexin 5, pika "f" të dokumentit vlerësues të projektit (PAD-it), parashikohen risqet e dështimit të projektit që mund të hasen gjatë implementimit të tij. Këto risqe janë kushtet e paqendrueshme politike dhe sociale të vendit dhe kapacitetet e dobëta kombëtare për zbatimin

efektiv të projektit. Por, dihet se gjatë periudhës së zbatimit të projektit nuk ka patur ndryshime politike dhe sociale. Pra, përgjegjësia për mosrealizimin e projektit i mbetet kapaciteteve të dobëta menaxhuese të gjithë aktorëve që janë marrë me zbatimin e projektit.

Megjithëkëtë, ndryshimet e kërkuara janë miratuar me VKM nr. 153, datë 13.3.2003. Shpërndarja e kredisë në bazë të këtij vendimi sipas kategorive të shpenzimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kategoria	Shuma e kredisë së Alokuar (SDR)	Shuma e kredisë së ndryshuar (SDR)	% e shpenzimeve të financuara
1	Punët civile	5,800,000	3,970,000	90%
2	Mallrat	4,100,000	3,870,000	100%
3	Shërbimet e konsulencës, bursat e trajnimit	1,400,000	3,000,000	100%
4	Kostot operative	75,000	1,264	8%
5	Te paalokuara	1,225,000	1,758.736	
	Totali	12,600,000	12,600,000	

Pra, është ndryshuar shuma e planifikuar për punime civile duke e pakësuar për 1 830 000 SDR, kryesisht është prekur vlera e ndërtimit të Spitalit të Ri për Sëmundjet e Brendshme në Qendrën Spitalore Universitare dhe kjo shumë është shpërndarë në kategoritë e tjera, kryesisht në shtesë të asistencës teknike për 1 600 000 SDR. Kështu, kategoria e asistencës teknike është rritur nga 1 400 000 SDR ose 14% që zinte në marrëveshjen fillestare në 3 000.000 SDR ose 23%. Ndërsa kategoria punime civile nga 5 800 000 SDR ose 46% që zinte në marrëveshjen fillestare është ulur për 3 970 000 SDR ose në 31.5%. Ndryshimet sipas kategorive nuk janë shoqëruar me ndryshimet përkatëse apo ndryshimet analitike në vlera që do të pësojnë elementët përbërës të çdo kategorie. Gjithashtu këto ndryshime nuk janë pasqyruar të detajuara në një plan prokurimesh të rikompozuar.

• Realizimi i shpenzimeve sipas kategorive të kredisë në funksion të çdo komponenti të projektit të përcaktuar në VKM nr. 153, datë 13.3.2003 deri në përfundim të projektit datë 31 dhjetor 2003, paraqitet si më poshtë:

1. Punet civile

Janë të planifikuara në VKM e mësipërme të ndryshuar në vlerën 3 970 000 SDR ose 5 359 500 USD.

Punimet që përfshihen në këtë kategori janë:

- Rehabilitimi radikal i ndërtesës së Onkologjisë;
- Ngritja e qendrës Biomedikale (ndërtim + pajisje);
- Rehabilitim e qendrës historike të QSUT

Ne fakt, për periudhën 01.01.2003 deri në 31.12.2003, nuk është kryer dhe disbursuar asnjë fond për këtë kategori (punimet civile). Pra, edhe pas ndryshimit të marrëveshjes **për kategorinë punime civile nuk ka realizim.**

2. Mallrat.

Në baze të VKM-së së ndryshuar mallrat janë planifikuar në vlerën 3 870 000 SDR ose 5 224 500 USD si më poshtë:

- Blerja e një paketë pajisjesh mjekësore për të gjithë spitalin;
- Pajisje të ndryshme mjekësore;
- Pajisje zyre dhe mjete transporti;
- Mobilje orendi.

Ne fakt, për periudhën 01.01.2003 deri në 31.12.2003 nuk është kryer dhe disbursuar asnjë fond për këtë kategori.

3. Shërbimet e konsulencës, bursat dhe trajnimit.

Janë planifikuar në marrëveshjen fillestare dhe të ndryshuar me VKM-ne e mësipërme në vlerën 3 000 000 SDR ose 4 050 000 USD. Në këtë zë përfshihen:

- Përmirësimi i trafikut të QSUT;
- Asistence teknike për strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;

- Konsulencë për vlerësimin e nevojave të komunitetit;
- Asistencë për buxhetet kombëtare të shëndetësisë;
- Asistencë për hartimin e buxhetit.

Në fakt, për periudhën 01.01.2003 deri në 31.12.2003, shërbimet e konsulencës, bursat dhe trajnimet janë realizuar në masën 499 373 USD e fondeve të planifikuara. Në vlerë progresive është realizuar 1 606 508 USD me këtë destinacion:

- Asistenca teknike për zhvillim politikash në vlerën 218 979 USD; ku përfshihen shërbimet e konsulencës për NJKP lokale dhe të huaj, asistenca teknike për strategjinë HIV/AIDS e Ministrisë së Shëndetësisë, asistencë teknike e Ministrisë së Shëndetësisë për vlerësimin e nevojave të komunitetit, asistencë teknike – Ministria e Shëndetësisë për konferencë, asistencë teknike për master planin rajonal të Tiranës, etj.

- Asistenca teknike për kapacitete ndërtues dhe zbatim projekti në vlerën 192.560 USD; ku përfshihen asistencë teknike - arkitektura dhe tarifat inxhinierike - autoritetet e shëndetit rajonal – lokale, asistencë teknike - arkitekturë & tarifa inxhinierike - qendrat rurale lokale; asistencë teknike për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për master planin për projektim, pajisje dhe supervizion etj.

- Trajnime jashtë vendit në vlerën 33 820 USD;
- Trajnime brenda vendit nuk ka;
- Pagat e personelit të PCU në vlerën 53 974 USD.

4. Kostot operative.

Në bazë të VKM-së së mësipërme janë planifikuar 1 264 SDR ose 1 706 USD.

Në fakt, për periudhën 01.01.2003 deri në 31.12.2003, shpenzimet operative janë realizuar në vlerën 1 220 USD dhe në progresiv nga fillimi i projektit në vlerën 88 795 USD.

Sa u trajtua me lart, gjatë periudhës 01.01.2003 deri në 31.12.2003, fondet e disbursuara dhe të përdorura janë në vlerën 500 593 USD, respektivisht: punimet civile 0 USD, mallrat 0 USD, asistenca teknike 499 373 USD dhe kosto operative 1 220 USD.

Në vlerë progresive janë disbursuar dhe përdorur 4 542 616 USD, respektivisht: punimet civile 1 129 500 USD, mallrat 1 717 813 USD, kosto operative 88 795 USD dhe konsulenca teknike 1 606 508 USD.

Siç shihet, konsulenca teknike ka zënë 99.7% të të gjithë fondeve të përdorura gjatë kësaj periudhe dhe në raport me planin, sipas VKM, kjo kategori është realizuar 39.6%. Pra përsëri edhe për kete periudhë, rëndësi i është kushtuar asistencës, duke lënë punimet civile dhe mallrat të paralizuar apo në vlerë absolute **0 USD**.

Pra në total, kredia e disbursuar dhe përdorur deri me 31.12.2003 është në vlerën 4 542 616 USD nga 17 milionë USD ose **26,7%** e fondit të kredisë dhe mbeten të paalokuara afërsisht 12 522 552 USD ose 83% e kredisë.

Përsëri ndodhur para kësaj situatë, në janar 2004 filluan negociimet për shtyrjen e afatit dhe ndryshimin e komponentëve të marrëveshjes së kredisë. Me shkresën nr. 463/1, datë 19.02.2000, Ministria e Shëndetësisë i ka nisur për mendim disa ministrive të linjës projektvendimin për ndryshimin e komponentëve, kategoritë e shpenzimeve të kredisë si dhe shtyrjen e afatit të projektit. Në relacionin bashkëlidhur, shkresës jepen përsëri të njëjtat komente dhe justifikime për ndryshimin e projektit si në relacionin e kërkuar për ndryshim në VKM nr. 153, datë 13.3.2003, si më poshtë:

- Nuk është arritur konsensusi në lidhje me programin mjekësor të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë.
- Për shkak të vonësive në legjislacionin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës.
- Aktivitetet nuk mund të përfundojnë dot brenda kohës zyrtare të mbylljes së projektit e cila është 31 janar 2004, prandaj kërkohet shtyrje e projektit edhe për 12 muaj, deri më 31 janar 2005.

Edhe në këtë relacion, nga Njësia e Koordinimit të Projektit nuk janë përcaktuar vlerat analitike të parashikuara për çdo zë shpenzimi që duhen për ndryshimet e projektit, veprim ky

që vështirësoi punën e kontrollit për të vlerësuar realizimin analitik të të gjithë zërave sipas kategorive të shpenzimeve.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 04.3.2004 u miratua në parim ndryshimi i marrëveshjes së kredisë. Vendimi përcakton shtyrjen e afatit zyrtar të mbylljes së projektit deri në 31 janar 2005, si edhe pakësim në masën 2 700 000 SDR nga shuma totale e kredisë, pra zbritjen e kredisë në shumën 9 900 000 SDR, nga 12 600 000 SDR të marrëveshjes fillestare.

Shpërndarja e kredisë sipas shpenzimeve paraqitet sipas tabelës:

Nr	Kategoria	Shuma e kredise se ndryshuar (SDR) mars 2003	% e shpenzimeve te financuara
1	Punët civile	1.900.000	90%
2	Mallrat	5.000.000	100%
3	Shërbimet e konsulences, bursat dhe trajnimet	3.100.000	100%
4	Kostot operative	1,264	8%
5	Të paalokuara	398.554	

• Realizimi sipas kategorive të shpenzimeve, në funksion të çdo komponenti të projektit të përcaktuar në VKM nr. 117, datë 04.3.2004, deri në përfundim të projektit, paraqitet si me poshte:

1. Punët civile

Në bazë të VKM nr. 117, datë 04.3.2004, punimet civile të planifikuara janë 1 900 000 SDR ose 2 565 000 USD.

Në fakt deri në fund të projektit janë realizuar në vlerë progresive 1 762 539 USD ose 68% e fondeve të planifikuara të ndryshuara për këte kategori janë perdurur me këtë destinacion:

- Nga 37 objekte shëndetësore të planifikuara në marrëveshjen fillestare u ndërtuan vetëm 13 qendra shëndetësore dhe 4 poliklinika me vlerë 1 108 009 USD;
- U rehabilitua pjesërisht Spitali Onkologjik me vlerë 171 389 USD;
- U rehabilitua godina e trajnimit në Institutin e Shëndetit Publik me vlerë 192 210 USD;
- Rikonstruksione të tjera në vlerën 290 931 USD.

2. Mallrat.

Në bazë të VKM-së nr. 117, datë 04.3.2004, mallrat janë planifikuar në vlerën 5 000 000 SDR ose 6 750 000 USD.

Në fakt deri në fund të projektit janë realizuar në vlerë progresive 7 645 441 USD ose 113% e fondeve të planifikuara për këtë kategori.

Ky realizim paraqitet me këtë destinacion:

- pajisjet mjekësore, në vlerën 6 832 972 USD;
- pajisje zyre dhe mjete transporti, në vlerën 266 138 USD;
- mobilje orendi, në vlerën 461 534 USD;
- mobilje orendi, automjete dhe pajisje për NJKP, në vlerën 84 797 USD.

3. Shërbimet e konsulencës, bursat dhe trajnimet.

Në bazë të VKM-së nr. 117, datë 04.03.2004 janë planifikuar 3 100 000 SDR ose 4 185 000 USD.

Në fakt deri në fund të projektit janë realizuar 2 977 961 USD ose 71% e fondeve të planifikuara për këtë kategori, sipas VKM-ve të ndryshuara. Këto fonde janë përdorur me këtë destinacion:

• Asistencë teknike për zhvillim politikash në vlerën 1 127 814 USD, ku përfshihen shërbimet e konsulencës për NJKP lokale dhe të huaj, asistencë teknike për strategjinë HIV/AIDS e Ministrisë së Shëndetësisë, asistencë teknike e Ministrisë së Shëndetësisë për vlerësimin e komunitetit, asistencë teknike e Ministrisë së Shëndetësisë për konferenca, asistencë teknike e Ministrisë së Shëndetësisë për përgatitjen e legjislacionit etj.

• Asistencë teknike për kapacitete ndërtues dhe zbatim projekti në vlerën 1 164 mijë USD; ku përfshihen asistencë teknike për arkitekturë dhe tarifa inxhinierike për autoritetet e

shëndetit rajonal, lokal, asistencë teknike për arkitekturen dhe tarifin inxhinierike për qendrat rurale lokale; asistencë teknike për Qendren Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për master planin, për projektim, planifikim pajisje dhe supervizim 953 400 USD etj.

- Trajnime jashtë vendit, në vlerën 318 958 USD;
- Trajnime brenda vendit, në vlerën 5 780 USD;
- Pagat e personelit të PCU, në vlerën 362 041 USD.

Të krahasojme realizimin e këtij zëri me marrëveshjen fillestare rezulton me tejkalim në masen 181%.

4. Kostot operative.

Të planifikuara janë në vlerën 1 264 SDR ose 1 706 USD;

Në fakt deri në fund të projektit janë realizuar 88 795 USD.

Siç shihet deri në përfundim të projektit, kredia është disbursuar dhe përdorur në vlerën 12 474 736 USD ose 73,3% e totalit të kredisë fillestare. Bëjmë një përmbledhje në dinamikë të kategorive të shpenzimeve:

1. Punimet civile, sipas ligjit janë planifikuar 8 616 100 USD, si pasojë e mosrealizimit të tyre me VKM nr. 153, datë 13.03.2003 u ndryshuan duke u reduktuar në 5 359 500 USD. Përsëri nuk u realizuan dhe me VKM nr. 117, datë 04.03.2004 u ndryshuan duke u reduktuar në 2 565 000 USD. Deri në përfundim të projektit janë realizuar në masen 1 762 539 USD ose 20.4 % e totalit të këtij zëri të kredisë, të përcaktuar në marrëveshjen fillestare.

2. Mallrat, sipas ligjit janë planifikuar 6 664 000 USD, si pasojë e mosrealizimit, me VKM nr. 153, datë 13.03.2003 u reduktua në 5 224 500 USD. Përsëri nuk u realizuan dhe me VKM nr. 117, datë 04.03.2004 u ndryshuan në rritje për 6 750 000 USD. Deri në përfundim të projektit janë realizuar në masën 7 645 441 USD ose 114,7% e totalit fillestar të këtij zëri të kredisë.

3. Kostot operative sipas ligjit janë planifikuar 119 500 USD, me VKM nr. 153 u ndryshuan në 1 706 USD. Deri në përfundim të projektit janë realizuar në masën 88 795 USD ose 74,3% e totalit fillestar të këtij zëri të kredisë.

4. Konsulenca teknike sipas ligjit është planifikuar 1 645 200 USD, deri më 31.12.2002 është realizuar 1 107 135 USD. Me VKM nr. 153, date 13.3.2003, u ndryshua në rritje në shumën 4 050 000 USD. Deri më 31.12.2003 u realizua në shumën 1 606 508 USD dhe me VKM nr. 117, datë 04.3.2004, përsëri u ndryshua në rritje në shumën 4 185 000 USD. Deri në përfundim të projektit janë realizuar në masën 2 977 961 USD ose 181% e totalit fillestar e këtij zëri të kredisë.

Sa u përshkrua më sipër, zëri “konsulencë teknike” është tejkaluar për 1 332 761 USD dhe ky fond është mbuluar nga fondet e përdorura të punimeve civile të cilat janë 6 853 561 USD. Del qartë se mosrealizimi i punimeve civile dhe tejkalimi i shpenzimeve të konsulencës ka sjellë pasojën e mosrealizimit të objektivave të projekti, çka e ka çuar projektin në dështim të plote.

• Për sa më sipër po bëjmë një përmbledhje të vlerësimit të ecurisë së projektit të ndarë analitikisht sipas komponentëve:

2. Realizimi i komponenteve.

Shpërndarja e kredisë sipas komponentëve të marrëveshjes, të ndarë sipas donatorëve bazuar në dokumentin e vlerësimit të projektit (PAD) dhe miratuar me ligjin nr. 8380, datë 29.7.1998, paraqitet si më poshtë:

Në 000 USD

KOMPONENTET PROJEKTIT	FINANCUES						Total
	Të financuara		TE PAFINANCUARA				
			DONATORE TE MUNDSEHEM				
	Qeveria Shqiptar	WB/IDA	IT. Gov	UK	USAID	Të tjerë	
A. Ngritja e kapaciteteve nacionale							
A1. Min. Shendetësisë		265.2	870.1		95.6		1230.9
A2. Instit. Sigurimeve	82.8	349		448.9			880.7
Shuma	82.8	614.2	870.1	448.9	95.6		2111.6

B. Autoriteti Rajonal ne Tirane	68.9	1266.8					1335.7
C. Strukturat e Shëndetësisë, Tirane							
C1. Qendra shendetës-rurale	133.4	1,009.2					1142.6
C2. Qendra shendetës-urbane	267.8	1,862.7					2130.5
C3. Poliklinikat	519.3		4,509.50				5028.8
C4. Spitali	1,276.70	11,750.4			1,947.00		14,974.10
C5. Trajnime aftesisimi profesional			730.5				730.5
Shuma C	2197.2	14,622.30	5239.5		1,947.00		24006
D. Menaxhimi projektit	23.4	542.6					566
Totali	2,372.3	17,045.90	6,109.60	448.9	95.6	1,947.00	28,019.30

A. Realizimi i komponentit “Ngritja e kapaciteteve kombëtare”. Shuma e parashikuar është 614 mijë USD.

Ky komponent ka patur si synim të mbështesë ngritjen dhe funksionimin e institucioneve që do të realizojnë decentralizimin e planifikimit dhe menaxhimit në nivel rajonal të Tiranës. Ishte parashikuar të përfundonte për tre vjet, institucionet përfituese janë Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Ky komponent paraqitet me këtë realizim:

- Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë është realizuar pjesërisht;
- Strategjia Kombëtare HIV/AIDS ka përfunduar e cila është lancuar në pranverën e vitit 2004;
- Ka përfunduar Strategjia e Reformës në Sektorin Shëndetësor;
- Nuk ka përfunduar Strategjia Kombëtare e planifikuar për burimet e shëndetit njerëzor;
- Nuk kanë përfunduar protokollat klinike bazë të qendrave shendetesore;
- Nuk ka përfunduar plotësimi me paketen ligjore të nevojshme për këtë sektor.

B. Realizimi i komponentit “Ngritja e Autoritetit Rajonal të Shëndetësisë në Tiranë”. Shuma e parashikuar 1.266 mijë USD.

Ky komponent përfshin ngritjen e autoritetit shëndetësor, plotësimin e bazës ligjore dhe rehabilitimin e godines së tij.

Megjithëse është propozuar nga vetë Ministria e Shëndetësisë për t’u krijuar, ai gjatë gjithë periudhës së projektit ka qenë problematik. Kanë munguar njohuritë dhe kapacitetet e nevojshme për të përcaktuar problemet kyçe të shëndetësisë. Nuk ishin përcaktuar qartë kostot dhe rezultatet e pritura. Ka patur mospërputhje midis planifikimit dhe financimit si dhe mospërputhje midis propozimeve të Autoritetit Rajonal të Tiranës dhe Institutit të Shëndetit Publik, probleme të cilat nuk kanë qenë të qarta nga pala përfituese.

C. Realizimi i komponentit “Ngritja e Sistemit të Qendrave Shëndetësore në Tiranë”. Shuma e parashikuar 14.622 mijë USD.

Në këtë komponent janë parashikuar për t’u kryer:

- Punët civile në të cilin përfshihen, ngritja rrjetit të sistemit shëndetësor në Tiranë, pajisje mjeksore, ngritja dhe pajisja e një spitali, tre poiklinikave dhe 37 qendra shëndetësore;
- Asistencë teknike për përmirësimin e shërbimeve mjeksore me pajisje mjeksore;
- Furnizimi dhe përshtatja me asistencë teknike për përdorimin e protokolleve klinike.
- Dhënie asistence teknike dhe mbështetje me qëllim sigurimin e një impakti pozitiv në ndihmë të shëndetit.

Ne planin e rishikuar u reduktua numri i qendrave shëndetësore që do të ndërtoheshin nga 37 në 33 qendra, prej të cilave u ndërtuan vetëm 16 qendra. U anulua shuma 8,6 milionë USD e cila ishte planifikuar për ndërtimin e Spitalit të Ri për Sëmundjet e Brendshme së bashku me pajisjet. Kjo shume u alokua në komponentët e tjerë me justifikimin e kohës së pamjaftueshme deri në fund të projektit dhe me vonesat në përgatitjen e masterplanit të rregullimit të Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës. Në fakt, mungesa e kapaciteteve menaxhuese ka sjellë pasojën e mosrealizimit të punimeve civile, pasi kontrata për përgatitjen e masterplanit të QSUT është lidhur në maj të vitit 2002 me kompaninë fituese në shumën

953.400 USD dhe pas kësaj ishin të gjithë mundësitë e realizimit të punimeve civile dhe të këtij komponenti.

D. Realizimi i komponentit “manaxhimi i projektit”. Shuma e parashikuar 542 mijë USD.

Përfshin pajisjen me asistencë teknike, trajnimi i stafit, pajisje zyrash me qëllim funksionimin e Njesisë së Koordinimit të Projektit.

Nga vlerësimi i dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga raporti i vleresimit përfundimtar që ka bërë Banka Boterorë për projektin rezulton se:

- projekti nuk është realizuar në nivel të kënaqshëm;
- performanca e projektit ka paraqitur shumë probleme të cilat lidhen me dobësi në efikasitet, efektivitet, përgjegjshmeri dhe përgjegjesi në menaxhim, të cilat kanë çuar në mosarritjen e qëllimit, për të cilin është krijuar dhe financuar ky projekt;
- Gjatë zbatimit dhe monitorimit të marrëveshjes nuk është zbatuar kalendari i veprimeve të parashikuara dhe të miratuara si dhe nuk kanë dalë në pah të metat ose edhe në rastet kur ato janë vënë në dukje apo janë rekomanduar nga Banka Boterore (midterm reviw) nuk janë marrë në konsideratë për të parandaluar pasojat deri në fund të projektit;
- asistencë e kërkuar nuk ka qenë e qartë se për çfarë do të shërbente, apo që fondet e alokuara dhe rialokuara nga kredia të shërbenin për rritjen e kapaciteteve në dobi të përfituesit, Ministrisë së Shëndetësisë.

3. Arritja e objektivave të projektit.

Marrëveshjen e kredise ka përcaktuar keto objektiva:

1. Fuqizimi dhe forcimi i burimeve dhe kapaciteteve njerezore dhe institucionale në dobi të efektivitetit të sektorit shëndetësor;
2. Përmirësimi i aksesit, efikasitetit dhe cilësisë në shërbimet shëndetësore.

Në përfundim, KLSH arrin në këtë konkluzion se:

Nuk janë arritur objektivat e projektit, për të cilat është marrë kredi nga Banka Boteror. Megjithatë projekti ka pësuar shumë ndryshime nga ana ligjore, ai përsëri nuk i ka arritur objektivat finale të përcaktuar në marrëveshjen e kredise të miratuar me ligjin nr. 8380, datë 29.7.1998 “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA), për projektin e rimëkëmbjes dhe të zhvillimit të sistemit shëndetësor”.

Gjatë gjithë periudhës së implementimit të projektit ka pasur mungesë përgjegjshmerie e përgjegjësie të kapaciteteve menaxhuese të njësisë së koordinimit të projektit, pasojat e të cilës ka sjellë denatyrimin e objektivave të projektit duke e çuar projektin në dështim të plotë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 8380, datë 29.7.1998, të miratuar dhe ratifikuar nga parlamenti “Për marrëveshjen e kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA), për projektin e rimëkëmbjes dhe të zhvillimit të sistemit shëndetësor”.

Për shkeljet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi ish-drejtori i NJKP dhe zëvendës-drejtori.

Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në marrëveshjen për realizimin e prokurimeve, zbatimin e kontratave për punimet civile, mallra e shërbime dhe administrimi i veprave të dorëzura.

Zbatimin e kriterëve dhe procedurave të prokurimit.

Gjatë implementimit të Projektit Rimëkëmbja e Zhvillimi i Sistemit Shëndetësor, Njësia e Koordinimit të Projektit (NJKP) ka zhvilluar gjithsej 76 tendera: nga të cilat: 20 tendera për punime civile me objekt ndërtimi dhe rehabilitimi i qendrave shëndetësore dhe poliklinikave të rajonit të Tiranës, 29 tendera me objekt blerje pajisje mjekësore e jomjekësore dhe 27 tendera me objekt shërbime të ndryshme konsulence.

Kontrolli mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për të gjithë tenderat e mësipërm (punimet civile, blerje pajisjeve dhe shërbimet e konsulencës), si dhe zbatimi i kontratave, për blerjen e pajisjeve dhe të shërbimeve të konsulencës është kryer i plotë nga kontrollet e mëparshme të KLSH deri në përfundim të projektit. Nisur nga kjo, kontrolli u përqendrua duke kontrolluar vetëm zbatimin kontratave për punimet civile, pasi ky kontroll nuk ishte kryer më parë.

2. Zbatimin e kontratave.

U kontrollua zbatimi i të gjitha kontratave të lidhura dhe në disa prej tyre u konstatuan këto shkelje:

Rehabilitimi i Qendrës Shëndetësore Yrshek.

Me datën 18.5.2001 është lidhur kontrata me firmën e ndërtimit sh.p.k. me vlerë fillestare 7 295 972 lekë dhe afat 75 ditë kalendarike. Punimet kanë filluar me datë 25.5.2001.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatua kjo shkelje:

- Aktkolaudimi dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të objektit të datës 24.8.2001 nuk është nënshkruar nga kolaudatorja, veprim ky që bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 7.

2. Rehabilitimi i Qendrës Shëndetësore Pezë e Madhe.

Me datën 18.5.2001 është lidhur kontrata me firmën e ndërtimit sh.p.k. me vlerë fillestare 6 452 774 lekë dhe afat 100 ditë kalendarike. Punimet kanë filluar me datë 24.5.2001.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatuan këto shkelje:

- Nuk ka garanci të kontratës konform klauzolës “49.1” të kushteve të kontratës dhe paragrafit “51” të të dhënave të kontratës nga banka, por nga shoqëri sigurimesh.
- Aktkolaudimi dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të objektit të datës 24.08.2001 nuk është nënshkruar nga kolaudatorja, veprim ky që bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 7.
- Nga kontrolli, verifikimi dhe matjet në vend të disa zërave të punimeve të kryera u konstatua se janë likujduar punime më shumë se ato të kryera në fakt.
- Konkretisht, diferencat janë konstatuar në këto zëra:

Nr.	EMËRTIMI I PUNIMEVE	Njësi	Çmimi	SASI		VLERA+STR.		DIFERENCA	
				Sit.	Fakt	Sit.	Fakt	Sasi	Vlerë
1	Ndërtim trotuari me pllaka çimentoje	m ²	1200	62	51	88460	72765	11	15694
Shuma						88460	72765		15694

Si pasojë e këtyre veprimeve është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 15 694 lekë.

Për shkeljet e mësipërme mbajnë përgjegjësi ish-drejtori i NJKP dhe supervizori i objektit.

3. Ndërtimi i Qendrës Shëndetësore Domje.

Me datën 20.6.2001 është lidhur kontrata, me firmën e ndërtimit sh.p.k. me vlerë fillestare 7 792 723 lekë dhe afat 90 ditë kalendarike. Punimet kanë filluar me datë 24.6.2001.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatua kjo shkelje:

- Aktkolaudimi dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të objektit të datës 24.08.2001 nuk është nënshkruar nga kolaudatorja, veprim ky që bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 7.

4. Ndërtimi i Qendrës Shëndetësore Paskuqan I.

Me datën 19.6.2001 është lidhur kontrata, me firmën e ndërtimit sh.p.k. me vlerë fillestare 7 514 443 lekë dhe afat 95 ditë kalendarike.

Punimet kanë filluar me datë 28.08.2001.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatuan këto shkelje:

- Në preventiv janë bërë shumë ndryshime jo vetëm në zëra pune, por edhe çmimet e ofertuara në tender janë rritur me procesverbal, kështu për gërmimin e dheut në seksion të lirë për 25 m³, nga 410 l/m³ bëhet 1 100 l/m³, gërmimi i themelit për 45 m³, nga 430 l/m³ bëhet 1500 l/m³, duke e rritur vlerën e objektit vetëm si rezultat i rritjes së çmimeve të ofertës për (25 x 690 + 45 x 1070) x 1.11 x 1.15 x 1.01 = **84 318 lekë**. Kjo përbën dëm ekonomik e ngarkon me përgjegjësi supervizorin e punimeve, e cila sipas procesverbalit përkatës ka ardhur nga fakti i ndryshimit të planvendosjes së objektit nga parashikimi i projektit, me faktin e pretendimeve të ngritura nga pronarët e truallit. Por kjo duhej bërë para caktimit të fondit të objektit, mbi bazën e një studimi për domosdoshmërinë e tij dhe të sanksionohet në lejen e sheshit të ndërtimit, që mungon në të gjithë dosjet e objekteve të kontrolluara.

Për shkeljen e mësipërme mban përgjegjësi supervizori i objektit.

5. Ndërtimi i Qendrës Shëndetësore Gjokaj.

Me datën 19.6.2001 është lidhur kontrata me firmën e ndërtimit sh.p.k. me vlerë fillestare 7 852 789 lekë dhe afat 95 ditë kalendarike. Punimet kanë filluar me datë 14.8.2001.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatuan këto shkelje:

- Në preventiv janë bërë shumë ndryshime jo vetëm në zëra pune, por edhe në çmimet e ofertuara në tender janë rritur me procesverbal. Kështu, për gërmimin e dheut, për sistemim ujrash të zeza, elektrikut e furnizimit me ujë për 52 m³, nga 600 l/m³ bëhet 1 200 l/m³, gërmimi i themelit për 35 m³, nga 650 l/m³ bëhet 1500 l/m³, etj., duke e rritur vlerën e objektit vetëm si rezultat i rritjes së çmimeve të ofertuara për 52 x (1200 – 600) x 1.1 x 1.14 x 1.01 + 35 x (1500 – 600) x 1.1 x 1.14 x 1.01 = **77 196 lekë**. Kjo përbën dëm ekonomik e ngarkon me përgjegjësi supervizorin e punimeve.

6. Ndërtimi i Qendrës Shëndetësore Dritas – Tapizë.

Me datën 09.11.2001 është lidhur kontrata, me firmën e ndërtimit me vlerë fillestare 8 497 182 lekë dhe afat 105 ditë kalendarike. Punimet kanë filluar me datë 21.11.2001.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatuan këto shkelje:

Nga kontrolli, verifikimi dhe matjet në vend të disa zërave të punimeve të kryera u konstatua se janë likuiduar punime më shumë se ato të kryera në fakt. Konkretisht, diferencat janë konstatuar në këto zëra:

nr.	EMËRTIMI I PUNIMEVE	Njësi	Çmimi	Sasi		Vlera + STR.		Diferenca	
				Sit.	Fakt	Sit.	Fakt	Sasi	Vlerë
1	Veshje fasade dhe xokoli me pllaka guri	m ²	3200	62	53	255790	218659	9	37131
2	Veshje me pllaka majolike banjo e lavamineve	m ²	2000	42	39	108298	100563	3	7736
3	Furnizim e vendosje fikse zjarri	copë	5500	2	1	11110	5555	1	5555
4	Vendosje pllaka betoni autoblokuese	m ²	1500	21	17.5	40612	33843	4	6769
Shuma						415810	358620		57190

Si pasojë e këtij veprimi është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **57 190 lekë**.

Për shkeljet e mësipërme mban përgjegjësi supervizori i objektit.

7. Ndërtimi i Qendrës Shëndetësore Pezë – Helmës.

Me datën 15.11.2001 është lidhur kontrata me firmën e ndërtimit sh.p.k. me vlerë fillestare 10 902 229 lekë dhe afat 105 ditë kalendarike. Punimet kanë filluar me datë 27.11.2001.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatuan këto shkelje:

Nga kontrolli, verifikimi dhe matjet në vend të disa zërave të punimeve të kryera u konstatua se janë likuiduar punime më shumë se ato të kryera në fakt.

Konkretisht, diferencat janë konstatuar në këto zëra:

Nr.	EMËRTIMI I PUNIMEVE	Njësi	Çmimi	SASI		VLERA		DIFERENCA	
				Sit.	Fakt	Sit.	Fakt	Sasi	Vlerë
1	Veshje fasade dhe xokoli me tulla dekorative	m ²	4000	61	57.3	304994	286494	3.7	18500
2	Veshje me pllaka majolike banjo e lavamaneve	m ²	1800	57	50.4	128248	113398	6.6	14850
3	Veshje shkallësh me mermer	m ²	5600	5	4.6	34999	32199	0.4	2800
4	Vendosje pllaka betoni autoblokuese	m ²	1800	55	46	123748	103498	9	20250
Shuma						591989	535590		56399

Si pasojë e këtij veprimi është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **56 399 lekë**.

Për shkeljet e mësipërme mban përgjegjësi supervizori i objektit.

8. Ndërtimi i Qendrës Shëndetësore Stermas.

Me datën 04.12.2001 është lidhur kontrata me firmën e ndërtimit sh.p.k. me vlerë fillestare 9 517 449 lekë dhe afat 115 ditë kalendarike. Punimet kanë filluar me datë 17.12.2001.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatuan këto shkelje:

- Nga kontrolli, verifikimi dhe matjet në vend të disa zërave të punimeve të kryera u konstatua se janë likuiduar punime më shumë se ato të kryera në fakt.

Konkretisht, diferencat janë konstatuar në këto zëra:

№	EMËRTIMI I PUNIMEVE	Njësi	Çmimi	SASI		VLERA		DIFERENCA	
				Sit.	Fakt	Sit.	Fakt	Sasi	Vlerë
1	Veshje fasade dhe xokoli me pllaka guri	m ²	3750	62	51	294471	242226	11	52245
2	Veshje shkallësh me mermer	m ²	5450	7	5.3	48319	36584	1.7	11734
3	Davancale mermeri për dritaret	m ²	5950	6.2	5.9	46723	44462	0.3	2261
4	Vendosje pllaka betoni autoblokuese	m ²	1900	23	19.5	54145	46925	3	7219
Shuma						443656	370197		73459

Si pasojë e këtij veprimi është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **73 459 lekë**.

Për shkeljet e mësipërme mban përgjegjësi supervizori i objektit.

9. Ndërtimi i Qendrës Shëndetësore Ura e Beshirit.

Me datën 19.9.2001 është lidhur kontrata me firmën e ndërtimit sh.p.k. me vlerë fillestare 8 301 133 lekë dhe afat 90 ditë kalendarike. Punimet kanë filluar me datë 18.10.2001.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatuan këto shkelje:

Nga kontrolli, verifikimi dhe matjet në vend të disa zërave të punimeve të kryera u konstatua se janë likuiduar punime më shumë se ato të kryera në fakt.

Konkretisht diferencat janë konstatuar në këto zëra:

Nr.	EMËRTIMI I PUNIMEVE	Njësi	Çmimi	SASI		VLERA		DIFERENCA	
				Sit.	Fakt	Sit.	Fakt	Sasi	Vlerë
1	Veshje fasade dhe xokoli me tulla dekorative	m ²	3700	62	53	285447	244011	9	41436
2	Davancale mermeri për dritaret	m ²	6000	6.2	5.8	46289	43302	0.4	2986
3	Shtresë trotuari me pllaka çimentoje	m ²	1000	52	28	64705	34841	24	29864
4	Bojler 20 litra	copë	5500	2	1	11110	5555	1	5555
5	Llampa luminishente	copë	3500	4	0	17420	0	4	17420
Shuma						424971	327709		97261

Si pasojë e këtij veprimi është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **97 261 lekë**.
Për shkeljet e mësipërme mban përgjegjësi supervizori i objektit.

10. Ndërtimi i Qendrës Shëndetësore Mullet.

Me datën 09.01.2002 është lidhur kontrata me firmën e ndërtimit sh.p.k. me vlerë fillestare 8 241 012 lekë dhe afat 110 ditë kalendarike. Punimet kanë filluar me datë 14.01.2002.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatuan këto shkelje:

- Nga kontrolli, verifikimi dhe matjet në vend të disa zërave të punimeve të kryera u konstatua se janë likuaduar punime më shumë se ato të kryera në fakt. Konkretisht, diferencat janë konstatuar në këto zëra:

Nr.	EMËRTIMI I PUNIMEVE	Njësi	Çmimi	SASI		VLERA		DIFERENCA	
				Sit.	Fakt	Sit.	Fakt	Sasi	Vlerë
1	Furnizim e vendosje pllaka çimentoje në trotuar	m ²	1000	61	41	77322	52400	19.5	24922
2	Veshje shkallësh me mermer	m ²	5200	3.8	2	25254	13292	1.8	11963
3	Davancale mermeri për dritaret	m ²	5800	6.2	5.8	45959	42994	0.4	2965
4	Vendosje pllaka betoni autoblokuese	m ²	1700	24	22	52145	46713	2.5	5432
Shuma						200680	155399		45281

Si pasojë e këtij veprimi është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **45 281 lekë**.
Për shkeljet e mësipërme mban përgjegjësi supervizori i objektit.

11. Rehabilitimi i Poliklinikës Nr. 2.

Me datën 12.12.2001 është lidhur kontrata me firmën e ndërtimit me vlerë fillestare 18 476 582 lekë dhe afat 115 ditë kalendarike. Punimet kanë filluar me datë 28.12.2001.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatuan këto shkelje:

- Me shkresën nr. 165 prot., datë 04.7.2002, ish-drejtori i NJKP i drejtohet njësisë së financës për pagesën e situacionit të punimeve të muajit qershor 2002, kontraktorit, në një kohë kur është lëshuar po prej tij urdhri për çngurtësimin e garancisë bankare me datën 21.6.2002, i cili duhet të lëshohet të paktën 28 ditë pas lëshimit të çertifikatës së përfundimit të punimeve, konformë klauzolës “49.1” të kushteve të kontratës.

• Nga kontrolli, verifikimi dhe matjet në vend të disa zërave të punimeve të kryera u konstatua se janë likuiduar punime më shumë se ato të kryera në fakt.

Konkretisht, diferencat janë konstatuar në këto zëra:

Nr	EMËRTIMI I PUNIMEVE	Njësi	Çmimi	SASI		VLERA		DIFERENCA	
				Sit.	Fakt	Sit.	Fakt	Sasi	Vlerë
1	Furnizim e vendosje pllaka çimentoje në trotuar	m ²	1000	26	23	33229	29395	3	3834
2	Veshje xokoli me pllaka majolike	m ²	2400	15	13.1	46010	40182	1.9	5828
3	Veshje fasade me pllaka majolike	m ²	2600	23	21.5	76428	71443	1.5	4984
4	Veshje me pllaka majolike e banjove	m ²	2150	123. 5	117.5	339355	322868	6	16487
5	Ndërtim çatie e lehtësuar	m ²	2750	361	336	1268788	1180922	25	87866
Shuma						1763810	1644811		119000

Si pasojë e ketyre veprimeve është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **119 000 lekë**.

Për shkeljet e mësipërme mbajnë përgjegjësi ish-drejtori i NJKP dhe supervizori i objektit.

12. Rehabilitimi i Qendrës së Trajnimit pranë ISHP.

Me datën 30.4.2002 është lidhur kontrata me firmën e ndërtimit me vlerë fillestare 25 520 338 lekë dhe afat 110 ditë kalendarike. Punimet kanë filluar me datë 01.5.2002.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatuan këto shkelje:

• Në situacionin përfundimtar janë aplikuar mbi vlerën e pajisjeve shpenzimet plotësuese 6% dhe fitimi i kompanisë 7%. Nga ky veprim është rritur vlera e pajisjeve në 569 089 lekë. Këto përqindje duhej të aplikoheshin vetëm mbi vlerën e punëtorisë për montimin e pajisjeve dhe jo mbi vlerën totale të zërave të punimeve. Konkretisht, po i paraqesim në tabelën e mëposhtme:

Nr.	EMËRTIMI I PAISJEVE	Njësi	Sasi	Çmimi	Vlera me struktura (6% e 7%)	Vlera e situac. pa struktura (6% e 7%)	Vl. e paguar tepër nga strukturat
1	Kaldajë me naftë	copë	1	163750	185725	163750	21975
2	Kondicionierë të tipit Fan-coil	copë	6	30200	205517	181200	24317
3	Pompa elektrike të ndryshme	copë	3	67517	229732	202550	27182
4	Central telefonik me 40 njësi telefonike	copë	1	224000	254061	224000	30061
6	Rezervuarë për ujë e naftë	copë	3	47667	162191	143000	19191
7	Radiatorë për ngrohje me korant	copë	38	16018	690388	608700	81688
8	Panele shpërndarës fuqie	copë	4	29750	134970	119000	15970
9	Modul shpërndarjeje	copë	1	49000	55576	49000	6576
10	Paneli dhe sirena e zjarfikses	copë	1	102200	115915	102200	13715
11	Boljerë të vegjël	copë	3	4950	16843	14850	1993
12	Ftohës	copë	1	405000	459351	405000	54351
13	Llampa të ndryshme	copë	190	3512	756908	667350	89558
14	Gjenerator prodhim energjie	copë	1	1360000	1542512	1360000	182512
Shuma							569089

Ky veprim bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 2, datë 08.5.2003 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", kreu I, pika B – Punimet e montimit, paragrafet 1 deri 7 (pika 6 p.sh. citojmë: "Montimi i bulirëve, pompave, aspiratorëve, kondicionerëve, rezervuarëve, qendror e vendorë, matësve të ujit, gazit, energjisë, aparatëve telefonikë etj. në ndërtesat e instalimet e çdo lloji, si dhe i armaturave të ndryshme, si

saraçineska, valvola etj., të komanduara me energji elektrike ose pneumatike etj.” dhe kreu II, pika B – shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, paragrafi i dytë, citoj; “*ndërsa për punimet e montimit të pajisjeve dhe makinerive, me përqindje mbi pagat bazë e shtesë të fuqisë punëtore, që merret me punimet e montimit*”.

Për shkeljen e konstatuar më sipër mban përgjegjësi supervizori i objektit.

13. Rehabilitimi i Drejtorisë së Higjienës dhe Epidemiologjise-DH E.

Me datën 30.4.2002 është lidhur kontrata me firmën e ndërtimit me vlerë fillestare 12 236 817 lekë dhe afat 90 ditë kalendarike. Punimet kanë filluar me datë 01.5.2002.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatuan këto shkelje:

- Bazuar në aktkolaudimin e datës 10.10.2004, zbatimi i kontratës ka zgjatur 105 ditë nga 90 ditë sipas përcaktimit në kontratë, d.m.th. 15 ditë vonesa e për të cilat NJKP duhej të kishte llogaritur e mbajtur kamatëvonesa konform klauzolës 42 të kushteve të kontratës dhe paragrafit 30 të të dhënave të kontratës në shumën 15 ditë vonesa x 12 226 308 x 0.05/ditë vonesa = **91 697 lekë**.

Kjo shumë përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi supervizorin dhe drejtorin e NJKP.

- Në situacionin përfundimtar janë aplikuar mbi vlerën e zërave të punimeve për montimin e pajisjeve shpenzimet plotësuese 5% dhe fitimi i kompanisë 5%. Nga ky veprim është rritur vlera e pajisjeve në 66 488 lekë. Këto përqindje duhej të aplikoheshin vetëm mbi vlerën e punëtorisë për montimin e pajisjeve dhe jo mbi vlerën totale të zërave të punimeve. Konkretisht, po i paraqesim në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i pajisjeve	Njësi	Sasi	Çmimi	Vlera me struktura (5% e 5%)	Vlera e situac. pa struktura (5% e 5%)	Vlera e paguar tepër nga struktura t
1	Buljirë të ndryshëm	copë	18	5418	107516	97520	9996
2	Pompë elektrike të ndryshme	copë	1	29600	32634	29600	3034
3	Rezervuarë për ujë 5000 l	copë	1	53500	58984	53500	5484
4	Diferencialë 3 fazorë të ndryshëm	copë	7	3790	29249	26530	2719
5	Automate manjeto termik	copë	61	1146	77098	69930	7168
6	Llampa të ndryshme	copë	120	3097	409667	371580	38087
SHUMA							66488

Ky veprim bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 2, datë 08.5.2003 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, kreu I, pika B – Punimet e montimit, paragrafet 1 deri 7 (pika 6, p.sh. citojmë: “*Montimi i bulirëve, pompave, aspiratorëve, kondicionerëve, rezervuarëve, qendrorë e vendorë, matësve të ujit, gazit, energjisë, aparateve telefonikë etj., në ndërtesat e instalimet e çdo lloji, si dhe i armaturave të ndryshme, si saraçineska, valvola etj., të komanduara me energji elektrike ose pneumatike etj.*” dhe kreu II, pika B – shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, paragrafi i dytë, citoj: “*ndërsa për punimet e montimit të pajisjeve dhe makinerive, me përqindje mbi pagat bazë e shtesë të fuqisë punëtore që merret me punimet e montimit*”.

Për kete shkelje të konstatuar mban përgjegjësi supervizori i objektit.

14. Rehabilitimi i Poliklinikës Nr. 10.

Me datën 30.4.2002 është lidhur kontrata me firmën e ndërtimit me vlerë fillestare 24 999 672 lekë dhe afat 180 ditë kalendarike. Punimet kanë filluar me datë 01.5.2002.

Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e kësaj kontrate u konstatuan këto shkelje:

- Bazuar në aktkolaudimin e datës 26.01.2005, zbatimi i kontratës ka zgjatur 195 ditë nga 180, dmth 15 ditë vonesa, e për të cilat: NJKP duhej të kishte llogaritur e mbajtur kamatë

vonesa konform klauzolës 42 të kushteve të kontratës dhe paragrafit 30 të të dhënave të kontratës, në shumën 15 ditë vonesa x 23 612 135 x 0.05 /ditë vonesa = **177 091 lekë**.

Kjo shumë përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi supervizorin dhe ish drejtorin e NJKP.

• Në situacionin përfundimtar janë aplikuar mbi vlerën e zërave të punimeve për montimin e pajisjeve shpenzimet plotësuese 11% dhe fitimi i kompanisë 15%. Nga ky veprim është shkaktuar dëmi ekonomik në vlerën **238 302 lekë**, pasi këto përqindje duhej të aplikoheshin vetëm mbi vlerën e punëtorisë për montimin e pajisjeve dhe jo mbi vlerën totale të zërave të punimeve. Konkretisht po i paraqesim në tabelën e mëposhtme:

Nr.	EMËRTIMI I PAJISJEVE	Njësia	Sasi	Çmimi	Vlera me struktura 11% e 15%	Vlera e situac. pa struktura 11% e 15%	Vlera e paguar tepër nga strukturat
1	Diferenciale tre fazorë	copë	5	6300	40210	31500	8710
2	Automate manjeto termikë	copë	59	1002	75441	59100	16341
3	Pompë elektrike të ndryshme	copë	2	6000	15318	12000	3318
4	Rezervuarë për ujë	copë	4	16500	84249	66000	18249
5	Fikse zjarri	copë	12	5000	76590	60000	16590
6	Buliera të vegjël	copë	50	3626	231429	181300	50129
7	Llampa të ndryshme	copë	159	2842	576914	451950	124964
Shuma							238302

Ky veprim bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 2, datë 08.5.2003, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, kreu I, pika B – Punimet e montimit, paragrafet 1 deri 7 (pika 6 p.sh. citojmë: “*Montimi i bulierëve, pompave, aspiratorëve, kondicionerëve, rezervuarëve, qendrorë e vendorë, matësve të ujit, gazit, energjisë, aparateve telefonikë etj. në ndërtesat e instalimet e çdo lloji, si dhe i armaturave të ndryshme, si saraçineska, valvola etj., të komanduara me energji elektrike ose pneumatike etj.*”, dhe kreu II, pika B – shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, paragrafi i dytë, citoj: “*ndërsa për punimet e montimit të pajisjeve dhe makinerive, me përqindje mbi pagat bazë e shtesë të fuqisë punëtore, që merret me punimet e montimit*”.

Për shkeljen e konstatuar më sipër mban përgjegjësi supervizori i objektit.

Gjithashtu nga kontrolli i dosjeve të zbatimit të objekteve rezulton se mungon leja e ndërtimit për ndërtimin apo rehabilitimin e objekteve, duke shkelur udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, kreu I – Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, paragrafi 4, pika a. Ky veprim përbën shkelje të disiplinës teknike në fushën e ndërtimit dhe ngarkon me përgjegjësi supervizorin.

3. Mbi administrimin e veprave të dorëzuara.

Nga ana e Njesisë së Koordinimit të Projektit (NJKP) janë marrë në dorëzim, përveç të tjerëve, punimet për 13 qendra shëndetësore, me vlerë të përgjithshme 108 005 142 lekë, të cilat janë në administrim të Autoritetit Shëndetësor Rajonal Tiranë. Nga kontrolli i dosjeve të zbatimit të projektit, që administrohen nga NJKP, janë verifikuar dhe janë gjetur për të gjitha këto objekte, procesverbalet e kolaudimit dhe ato të marrjes në dorëzim. Ndresa në Zyrat e Autoritetit Shëndetësor Rajonal Tiranë u kërkua dokumentacioni që disponon për qendrat shëndetësore, për ndërtimin apo rehabilitimin e tyre dhe nuk na u paraqit. Nuk disponohej asnjë lloj dokumentacioni, si procesverbali i marrjes në dorëzim, situacioni përfundimtar, dokument hyrje apo veprime në kontabilitet si dhe perfshirja e tyre në bilancet kontabël të autoritetit.

Duhet theksuar se këto objekte janë financuar e marrë në dorëzim në vitet 2001 e 2002, pra përpara 4 apo 5 vitesh dhe megjithëse ka kaluar gjithë kjo periudhë, akoma nuk janë bërë

veprimet e duhura për të shtuar vlerën e aseteve të institucionit duke i regjistruar ato në kontabilitet.

Ky veprim bie në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, kreu III – Parimet dhe përbërësit e pasqyrave financiare, neni 9 – Respektimi i standardeve kontabël. Ky veprim përbën shkelje të disiplinës financiare.

Për shkeljet e cilësuar më sipër mbajnë përgjegjësi ish-drejtori i NJKP dhe përgjegjësjë e financës së Autoritetit Shëndetësor Rajonal Tiranë.

Mbi organizimin dhe funksionimin të Njesisë së Zbatimit të Projektit, rregullshmëria e shpenzimeve administrative të kryera.

Në zbatim të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 8380, datë 29.7.1998, për projektin e rimekembjes dhe të zhvillimit të sistemit shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë ka ngritur Njësinë e Koordinimit të Projektit. Njësia përbëhet në strukturë nga 8 punonjës, përfshirë edhe Drejtorinë e Njesisë.

Për ushtrimin e veprimtarisë së saj, Njësia e Koordinimit të Projektit mbështetet me fonde nga zëri i kredisë “asistence teknike” dhe “kosto operative”, për shpenzime komunikimi, printimet, publikimet, përdorimi i automjeteve dhe mirëmbajtja e tyre, transportimin dhe inspektimin në terren, shpërblime paga etj. Kosto operacionale e Njesisë për të gjithë periudhën e zbatimit të projektit është në vlerën **266,855 USD**, e cila është mbuluar nga fondet e kredisë.

Nga kontrolli i kryer mbi ligjshmërinë e përdorimit të këtyre shpenzimeve u konstatua se, në përgjithësi, janë kryer në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Por u vërejt se gjatë periudhës së implementimit të marrëveshjes nga NJKP-ja janë likuiduar për shërbime të ndryshme nga zëri konsulence teknike 27 subjekte private vendas dhe të huaja, në shumën gjithsej 2 142 549 USD. Këto subjektet nuk janë regjistruar në zyrën e tatimtaksave. Të gjitha pagesat e mesiperme për çdo rast, në bazë të kërkesës së bërë nga vetë subjektet, janë likuiduar direkt nga Banka Boterore apo nga llogaria speciale e projektit pranë Raiffaisen Bank. Pagesat janë kryer në formë transferte, direkt në llogaritë e subjekteve të mesiperme në vendet e tyre, pa u deklaruar me parë në Zyren e Tatimtaksave. Ky veprim ka bërë që konsulentët për të ardhurat që kanë përfituar në Shqipëri në vlerën 2 187 128 USD nuk ka derdhur në Zyren e Tatimtaksave tatimin në burim në masën 15%, në vlerën 328 069 USD, duke i shkatuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në këto vlerë.

Mosdeklarimi i të ardhurave dhe mosregjistrimi i tyre në Zyren e tatimtaksave, si dhe mospagimi i tatimit në burim, përbën shkelje të nenit 24, kreut II, të ligjit nr. 8560, datë 2.12.1999 “Për procedurat tatimore” me ndryshimet përkatëse, të udhëzimeve të Ministrisë së Financave të nxjerra në zbatim të tij, të pikës 1, germa d dhe dh, të nenit 33, të kreut IV, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me ndryshimet përkatëse, të udhëzimeve të Ministrisë së Financave të nxjerra në zbatim të tij, dhe të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 6, datë 10.02.2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangjen e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”.

Për shkeljet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi ish-drejtori i NJKP, pasi nuk ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të mundësuar regjistrimin e kompanive në organet tatimore.

▪ Për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen nga ana e KLSH u rekomanduan masa organizative dhe masa për zhdëmtim, për t’u zbatuar nga subjekti.

2. KONTROLL NË PROJEKTIN E FINANCUAR NGA AGJENCIA FRANCEZE E ZHVILLIMIT PËR KLINIKËN E SPECIALITETEVE KIRURGJIKALE “KLAUDE BERNARD” NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE «NËNË TEREZA» TIRANË.

Në zbatim të programit të kontrollit nr. 802/1, datë 13.10.2006, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u ushtrua kontroll në Projektin e financuar nga Agjencia Franceze e Zhvillimit, për Klinikën e Specialiteteve Kirurgjikale “Klaude Bernard”, në Qendrën Spitalore Universitare «Nënë Tereza», Tiranë, projekt ky në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, me objekt kontrolli: “Mbi ligjshmërinë, rregullshmërinë financiare dhe vlerësimin e zbatimit të projektit”.

Kontrolli u krye nga data 30.10.2006 deri më datën 20.11.2006, sipas drejtimeve të përcaktuara në programin e kontrollit.

Nga kontrolli i ushtruar janë konstatuar mangësi e shkelje të dispozitave ligjore, të cilat sipas drejtimeve të programit të kontrollit konsistojnë:

Mbi kontrollin e marrëveshjes së lidhur midis palëve, realizimin e objektivave të projektit, funksionimi dhe organizimi i projektit dhe menaxhimi financiar.

Financimi i bërë nga Agjencia Franceze për Zhvillim në shumën 30 milionë franga franceze, ekuivalente me 4,6 milionë euro, bazohet në Memorandumin e nënshkruar midis Qeverisë Shqiptare dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, në datën 13 tetor 1999 dhe në Marrëveshjen e Financimit nr. CAL 1000 01 V, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministri i Shëndetësisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim. Marrëveshja e Bashkëpunimit Ekonomik, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Franceze, për mbështetjen financiare dhënë në formë granti, për ndërtimin dhe pajisjen e Klinikës së Specialiteteve të Kirurgjisë, pranë QSUT “Nënë Tereza”, është miratuar me VKM nr. 326, datë 23.6.2000.

Projekti “Klinika e Specialiteteve Kirurgjikale pranë QSUT-së” është parashikuar për të u zbatuar për një periudhë katërvjeçare 2000-2004, kjo sipas marrëveshjes së financimit nr. CAL 1000 01 V, në nenin 5 të saj, kreu II, ku përcaktohet data limit, që do të jetë 31.12.2004.

Projekti ka si objekt kryesor modernizimin e Qendrës Spitalore, duke financuar ndërtimin e një klinike të re, pajisjen, formimin e personelit në specialitete të ndryshme.

Zbatimi i projektit do të arrihet nëpërmjet realizimit të 4 zërave, si tabela e mëposhtme:
Në 000/euro

Nr.	Emërtimi	Buxheti fillestar	Buxheti i rialokuar	Kontrata	Shtesa kontrate
1	Ndërtime	2 310	2 579	1 985	595
2	Pajisje	1 020	1 016	1 016	
3	Trajnime asistencë	761	938	822	116
4	Të ndryshme, të paparashikuara	479	37		
	Totali	4 570	4 570	3 823	711

Duke iu referuar tabelës së mësipërme rezultojnë se janë realizuar të 4 zërat e marrëveshjes dhe disbursimi i fondeve në masën 100%.

Bazuar në nenin 3, pika 2, të marrëveshjes së lidhur midis palëve, për ekzekutimin e projektit nga ministri është caktuar me shkresën nr. 920, datë 15.3.2000, drejtori i projektit dhe koordinatori për implementimin e projektit.

Me shkresën nr. 3602, datë 27.12.2001 është ndryshuar koordinatori për implementimin e projektit.

Me shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 306/13, datë 04.7.2003 është caktuar drejtori i projektit të spitalit “Klinika e Specialiteteve Kirurgjikale”.

Në lidhje me mënyrat e derdhjes së fondeve, në nenin 7 të marrëveshjes është përcaktuar se: fondet do të derdhen nga agjencia, në çdo konto bankare, në Paris.

Nga kontrolli i pagesave rezultoi se ato janë kryer nga agjencia nëpërmjet llogarisë bankare të hapur për këtë projekt në Paris.

Gjithashtu, në nenin 4, paragrafi “Derdhjet e drejtpërdrejta nga agjencia” përcaktohet se: “Agjencia Franceze vepron me cilësinë e të mandatuarit nga qeveria dhe nuk do të ketë në asnjë moment për të verifikuar, nëse ekziston ndonjë pengesë juridike për derdhjet e kërkuara”.

Nga kontrolli i dokumentacionit të bankës në Ministrinë e Shëndetësisë, për periudhën shtator 2003 - nëntor 2005 rezultoi se pagesat e bëra nga buxheti i shtetit rezultuan në shumën **81 315 500 lekë**, ekivalente me **663 764 euro**.

Kontrolli i zbatimit të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në marrëveshjen e lidhur për realizimin e prokurimeve për ndërtime, shërbime e mallra.

1. Mbi studimin e fizibilitetit.

Studimi i fizibilitetit është realizuar nga Agjencia Franceze për Zhvillim AFZH, me mbështetjen e përfaqësuesit të Ministrisë së Shëndetësisë Shqiptare për këtë projekt. Ky studim u krye gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2000. Parametrat e llogaritura kanë dalë si rezultat i të dhënave të marra nga Drejtoria Spitalore, të bazuara në të dhënat e vitit 1998. Objekti i projektit është ndërtimi i klinikës me një sipërfaqe afro 4300 m² (për hospitalizim të plotë 1493 m², hospitalizimin ditor 463 m², sterilizim 240 m², blloku i operacioneve 726 m², konsultimi 934 m² dhe pritje-pranim 379 m²) e cila përmban: sallën e pranimeve me 60 shtretër shtrimi, 4 salla operacioni, dhomën e sterilizimeve dhe dhomën e vizitave. Projekti i ndërtimit është vlerësuar në shumën 2 771 700 euro, nga të cilat: për punimet 2 309 750 euro, vlerë e financuar nga AFZH dhe 461 950 euro, financuar nga Ministria e Shëndetësisë Shqiptare, si kontribut lokal për t.v.sh.

2. Mbi konsulencën dhe supervizionin.

Pas studimit të fizibilitetit, nga AFZH-ja kanë filluar procedurat për studimin teknik dhe financiar të projektit, e konkretisht:

Letra e mirëkuptimit e nënshkruar me 20.6.1999 nga ministri i Shëndetësisë i Republikës së Shqipërisë dhe Sekretari i Shtetit për Shëndetësinë dhe Veprimin Social të Republikës Franceze, i ngarkon Agjencisë Franceze të Zhvillimit (AFZH) të konkretizojë ndihmesën franceze në ndërtimin e një klinike të specialiteteve në Tiranë.

Në memorandumin e nënshkruar me datë 28.10.1999, nga ministri i Shëndetësisë dhe përfaqësuesi i AFZH-së është rënë dakort që: AFZH-ja do të parafinancoje tërësinë e studimeve paraprake dhe veçanërisht studimet teknike e financiare të projektit. Ministri i Shëndetësisë ka mandatuar AFZH-në që të drejtojë, në emër dhe për llogari të tij, procedurën e konsultimeve për studimin sipas termave të referimit të vendosura nga ajo. Mbi këtë bazë, analiza e ofertave për studimin teknik e financiar është zhvilluar nga AFZH, sipas ligjeve të saj të caktimit të tregjeve. Për këtë qëllim është caktuar shoqëria franceze me nënkontraktorin, shoqërinë shqiptare. Gjithashtu, ministri ka mandatuar AFZH-në, për organizimin e konkursit për drejtimin e punimeve dhe përzgjedhjen e kontrollorit teknik, për të cilët është dhënë edhe mendimi i saj miratues. Fituese janë 2 kompanitë franceze dhe 1 studio shqiptare.

Nga pala shqiptare është marrë përsipër paraqitja e provave të pronësisë së tokës ku parashikohet të realizohet projekti, sigurimi në kohën e duhur i kredive buxhetore të nevojshme për shembjen e ndërtesave ekzistuese në tokën në fjalë, si dhe për mbulimin e tatimeve që duhet të mbulojë projekti.

3. Mbi zhvillimin e tenderit për punimet e ndërtimit të Spitalit Francez.

Pas studimit paraprak të projektit nga AFZH-ja dhe përfundimit të konkursit për drejtimin e punimeve, drejtori i projektit nxori urdhrin e prokurimit për fillimin e procedurës për “Ndërtimin e Klinikës së Specialiteteve”.

Ftesa për ofertë është bërë me nr. 2362/1, datë 24.7.2002, e cila është botuar në disa gazeta shqiptare, me tirazh më të madh, si dhe nga AFZH në shtypin periodik francez. Dokumentet e tenderit janë blerë nga 12 kompani, ndërsa janë paraqitur në hapjen e ofertave vetëm 2. Grupimi ka ofruar të realizojë punime me një vlerë totale prej 1 984 406 euro (pa

përfshirë t.v.sh.) ose 2 381 288 euro me t.v.sh., me një afat ndërtimi 17 muaj. 2 grupimet kanë ofruar realizimin e punimeve me një vlerë totale prej 4 926 000 euro, me afat ndërtimi 18-muaj.

Relacioni përfundimtar i tenderit është përfunduar me datë 23.10.2002. Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është kërkuar marrja e miratimit për të rishpallur procedurën e tenderit, për arsyet e mëposhtme:

- Oferta e paraqitur nga grupimi nuk plotëson kriteret e kapacitetit të kamionëve sipas kërkesave të tenderit, preventivi nuk është sigluar nga kompania kryesore, si dhe është paraqitur vetëm në shqip dhe jo në frëngjisht. Me gjithë këto të meta, komisioni ka vlerësuar se ky grupim i plotësonte kriteret e kualifikimit.

- Nuk është arritur një konkurrence e mjaftueshme, kjo edhe për faktin se, në tender lejoheshin të merrnin pjesë vetëm kompani shqiptare dhe franceze.

- Në preventivin e përgatitur nga projektuesit janë identifikuar difekte, siç janë: harresa e blerjes dhe montimit të ashensorëve, punime hidroizolimi në bodrume, shtesa gipsi zjarrdruese, shtesë kaldajash etj.

Me shkresën e datës 03.12.2002, drejtuar Ministrinë të Shëndetësisë, AFZH thekson se, nga ana e firmave projektuese dhe asistentit të ministrisë së Shëndetësisë është konfirmuar për pranimin e plotë teknik të bashkimit. Rishpallja e tenderit do të shoqërohej me humbje të gjatë kohe, humbje cilësie (pasi firmat do të rishikonin uljen e shërbimeve) dhe rritje të shpenzimeve të mundshme, pasi asgjë nuk garanton se mund të sigurohen edhe një herë çmime kaq të favorshme dhe të ulëta. Për këto arsye, nga ana e AFZH-së nuk është dhënë (nonobjection). Ministria e Shëndetësisë i është drejtuar AFZH-së për dhënien e mundësisë së shtyrjes së afatit kufi, për përfundimin e projektit, me qëllim rishikimin e projektit të ndërtimit ose dhënien e garancisë nga ana e firmave projektuese dhe nga ana e AFZH-së, se edhe me preventivin aktual mbi bazën e të cilit është kryer konkurimi, ezaurohet cilësia e ndërtimit të klinikës, sipas të gjithë parametrave. Në këto kushte, nga ana e AFZH-së është rënë dakort për variantin e vazhdimit të procesit për lidhjen e kontratës me grupimin, me rregullimet që do t'i bëheshin projektit gjatë zbatimit të punimeve.

Mbi kontrollin e zbatimit të kontratave për punime civile.

1. Zbatimi i kontratës së lidhur për ndërtimin e spitalit.

Kontrata midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe firmës fituese është nënshkruar me datë 07.5.2003. Ceremonia e fillimit të punimeve për ndërtimin e klinikës është realizuar me 16.6.2003.

Pas fillimit të punimeve, kontratës i janë bërë tre shtesa. Shtesa e parë dhe e dytë kanë ardhur si pasojë e rregullimeve të projektit për gabimet e identifikuar që në fazën e tenderimit (nuk janë përfshirë në çmimin e punimeve ndërtimi i kaldajave dhe blerja e montimi i ashensorëve). Gjithashtu, gjatë punimeve të gërmimit kanë dalë masive betoni të paparashikuara, të cilat duhet të shkatërroheshin. Shtesa e tretë ka dalë si e domosdoshme, pasi nga ana e Bankës Botërore ishte parashikuar rehabilitimi i terreneve të QSUT, ndërtimi i rrjeteve kryesore të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, rrjetit elektrik, riparim të rrugëve etj., financim i cili nuk u realizua nga ana e saj. Kjo shtesë është realizuar në fazën përfundimtare të zbatimit të kontratës. Shuma totale e këtyre punime shtesë është në vlerën 214 422 euro. Në këtë shumë, AFZH ka financuar 90 981 euro dhe diferenca prej 123 440 euro është mbuluar nga Ministria e Shëndetësisë. Kjo shtesë ka të bëjë me punime për ndërtim rrugë të reja dhe sistemime rreth objektit, punime për sistemimin e rrjetit të jashtëm të shkarkimeve të ujërave të bardha e të zeza, rrugë hyrëse kryesore, prishje e tre godinave të vjetra, punime mekanike dhe elektrike. Pas nënshkrimit të shtesës së kontratës, me shkresën nr. 2371, datë 16.08.2005, i është kërkuar miratimi Ministrisë së Financave për transferimin e fondeve për mbulimin e punimeve që do të financohen nga Ministria e Shëndetësisë, miratim i cili është marrë me shkresë nr. 5242/1, datë 07.9.2005.

Pas përfundimit të punimeve për t'i paraprirë marrjes në dorëzim të objektit, me datë 11.5.2005, është mbajtur një procesverbal mbi verifikimin dhe kontrollin e punimeve të

realizuara. Procesverbali është mbajtur në prezencë të përfaqësuesit, të supervizorit dhe firmave të zbatimit të punimeve. Nga ky kontroll rezultoi se, punimet janë realizuar konform projektit, me disa vërejtje që kryesisht kishin të bënin me: Cmontimin e rrethimit provizor, pastrim dhe heqje mbeturinash nga objekti, punime të vogla mbrojtje tubacionesh, mbyllje fugash, vendosje pajisje kundrazjarrit, lyerje ambientesh, riparime pllakash, rregullime ndriçimi, lyerje tubash, riparime tavane të varura etj.

Në firmosjen e situacionit përfundimtar kanë marrë pjesë firmat zbatuese, përfaqësuesit e supervizorit, përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Në vlerën e situacionit përfundimtar është përfshirë edhe kontributi i Ministrisë së Shëndetësisë në vlerën 123 440 euro.

Me urdhër nr. 96, datë 21.3.06 të ministrit të Shëndetësisë është ngritur grupi i kolaudimit të objektit. Me shkresë nr. 28/4, datë 28.4.2006 është njoftuar Drejtoria e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, mbi përbërjen e grupit të kolaudimit dhe afatin e zbatimit të kolaudimit të punimeve të ndërtimit të objektit. Kolaudimi i objektit u realizua gjatë periudhës 03.5.2006 deri me 16.5.2006. Në procesverbalin e kolaudimit theksohet se, detyrat e lëna nga AFZH dhe supervizori në procesverbalin e datës 11.5.2005 janë realizuar nga ana e sipërmarrësve të punimeve.

Për marrjen në dorëzim të objektit, drejtori i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ka nxjerrë urdhrin nr. 27, datë 27.3.2006 “Mbi ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve të ndërtimit të Spitalit të Specialiteteve Kirurgjikale (Spitali Francez)”. Ky komision siç pranohet edhe në observacionin e bërë me shkresë nr. 1284/2, datë 04.12.2006, ka qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe në fund të kolaudimit nga ky komision nuk është mbajtur asnjë procesverbal për problemet që ekzistonin në fakt.

Drejtorja e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me shkresë nr. 1001, datë 06.12.2006, pra pas kryerjes së kolaudimit, i është drejtuar kompanive zbatuese të spitalit, mbikëqyrësit të punimeve dhe koordinatorit të projektit, në lidhje me disa vërejtje mbi zbatimin e punimeve. Vërejtjet kryesore të bëra janë: Mbi furnizimin me ujë të pijshëm, sistemin e ngrohjes qendrore (mungesë ambienti për personelin, mungesë ventilimi në sallë, derdhje teprica solari, pamundësi e largimit të ujërave të kaldajës në rast shkarkimi, si dhe në pavionin e okulistikës (nuk ka ngrohje qendrore), ka prezencë të lartë të gazeve anestetike, rrjedhje në periudhë shirash, disa dyer nuk mbyllen normalisht, nuk funksionon sistemi i sinjalistikës etj.

Nga ana e QSUT, objekti është marrë në dorëzim me datë 27.12.2006. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim të punimeve, theksohet se cilësia e punimeve është e mirë, por ka edhe vërejtje përsa i përket:

- Moskordinancës së sistemit të kondicionimit dhe ventilimit me aparataturat, megjithëse nga ana e firmës së montimit janë bërë ndërhyrje për përmirësimin e situatës.

- Sistemi i ngrohjes, me gjithë ndërhyrjet e përditshme nuk ka arritur të dërgojë ngrohje në pikat fundore.

- Rehabilitimi i ambienteve të punës në bodrum dhe furnizimit me lëndë djegëse të kaldajave.

- Ventilim të repartit të kaldajës dhe dekantim të ujërave të solarit.

- Dalja e autokllavit ka problem në shkarkim.

Për sa më lart, komisioni i marrjes në dorëzim të objektit ka evidentuar difektet 7 muaj pas kolaudimit.

Gjatë kontrollit të kryer në objekt nga grupi i kontrollit të KLSH të disa zërave të punime të realizuara, rezultuan këto difekte:

- Nuk funksionon sistemi i ventilimit të ajrit për sallat e operacionit, duke shkaktuar prezencë të lartë të gazeve anestetike.

- Nuk funksionon sistemi i alarmit në dhomat e të sëmurëve.

- Ka rrjedhje dhe lagështirë në sallën e reaminacionit, që vjen si shkak i punës së dobët për hidroizolim e banjove në katin e sipërm.

- Disa dyer dhe dritare nuk funksionojnë normalisht, nuk mbyllen dhe u janë dëmtuar brava dhe dorezat.

- Suvatimet në shumë vende kanë pësuar plasaritje, kjo e theksuar përgjatë parapetit të tarracës dhe në pragjet e dritareve.

- Në katin e dytë, pavioni ORL, pllakat e dyshemesë kanë pësuar shkëputje nga shtresa, si pasojë e punës së dobët për montimin e tyre.

- Ka difekte të shumta të montimit të pajisjeve hidrosanitare, pasi në shumë raste ato kanë rrjedhje, gjithashtu disa kapakë të kasetave të ujit janë dëmtuar.

Nisur për sa më lart, përgjegjësia bie mbi përfaqësuesin e supervisorit, grupin e kolaudimit, si dhe komisionin e ngritur për marrjen në dorëzim të objektit.

Supervizori dhe grupi i kolaudimit mbajnë përgjegjësi sepse disa nga difektet e konstatuara ekzistojnë para procesit të kolaudimit. Riparimi i këtyre difekteve dhe i atyre të dalë gjatë periudhës së garancisë së difekteve, duhej të ishin riparuar. Për mosriparimin e këtyre difekteve, kontraktorit duhej t'i mbahej garancia e kontratës. Këto veprime bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 12, si dhe me udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", kreu II, pika 3. Gjithashtu, komisioni i ngarkur për marrjen në dorëzim të objektit edhe pse ka qenë palë në kolaudim, nuk ka evidentuar difektet e konstatuara. Zgjatja e afatit të marrjes në dorëzim të objektit dhe mospenalizimi i firmave ndërtuese për riparinin e difekteve ngarkon me përgjegjësi drejtorin e QSUT, si dhe komisionin e marrjes në dorëzim.

2. Zbatimi i kontratës së lidhur për pajisjen e Spitalit të Specialiteteve Kirurgjikale pranë QSUT-së me aparatura mjekësore si dhe montimi i tyre.

Në kuadër të Marrëveshjes Financiare, në Lion të Francës më datë 06.12.2004 (pra rreth 25 ditë para përfundimit të projektit) është zhvilluar tenderi për blerjen, furnizimin dhe instalimin e pajisjeve mjekësore të cilat do të instaloheshin në Spitalin e Specialiteteve Kirurgjikale, në QSUT. Në këtë tender kanë marrë pjesë si vëzhgues nga pala shqiptare zëvendës-drejtori i QSUT-së dhe koordinatori i projektit. Tenderi është fituar nga shoqëria Itali.

Me shkresën nr. 284, datë 31.01.2005, nga ministri i Shëndetësisë është lëshuar autorizimi për lidhjen e kontratës në emër të Ministrisë së Shëndetësisë, nga zëvendës-drejtori i QSUT.

Kontrata me shoqërinë Itali është lidhur në shkurt të vitit 2005, në shumën 1 016 340 euro. Në këtë kontratë nuk ishte parashikuar afati i lëvrimit të këtyre pajisjeve.

Administrimi i veprave të dorëzuara.

a. Ndërtesa.

Me urdhrin nr. 27, datë 27.03.2006, nga drejtori i Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të godinës së Spitalit të Specialiteteve Kirurgjikale (Spitali Francez).

Ky komision duhet të asistonte në grupin e kolaudimit të ngritur nga Ministria e Shëndetësisë dhe pas përfundimit të kolaudimit do të merrte në dorëzim punimet.

Nga kontrolli i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të kontrollit, nuk rezultuan dokumente që vërtetonin marrjen në dorëzim të këtyre punimeve si dhe arsyet e mosmarrjes në dorëzim, veprim ky që bie në kundërshtim me udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", pika 10.2, ku theksohet se: "...Objekti merret në dorëzim në datën e nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit".

Për mosmarrjen në dorëzim të punimeve të objektit, përgjegjësia bie mbi anëtarët e komisionit të ngritur për marrjen në dorëzim të objektit dhe drejtorin e QSUT Tiranë, për mosndjekje të zbatimit të urdhrin të nxjerrë nga ana e tij.

Përsa i përket mirëmbajtjes së objektit, bazuar në marrëveshjen financiare, nga ana e Qeverisë është marrë angazhim për një rritje prej 4% të buxhetit vjetor të funksionimit të

Qendrës Spitalore Universitare, për të mbuluar shpenzimet e funksionimit të klinikës dhe një vlerë prej 0.5% të shumës së investimit të ndërtesës, për mirëmbajtjen e saj.

Pra, si konkluzion theksojmë se mosmarrja në dorëzim e punimeve të ndërtimit të kësaj klinike do të shkaktojë probleme përsa i përket mirëmbajtjes së këtij objekti, si dhe për parashikimet për ndërhyrje që mund të dalin të nevojshme në të ardhmen.

b. Aparaturat dhe pajisjet

Me urdhrin e brendshëm nr. 77, datë 09.8.2005, ish-drejtori i përgjithshëm ka urdhëruar shefat e klinikave të specialiteteve që të gjitha pajisjet e ardhura të cilat janë montuar, brenda datës 12.8.2005, të bëhen dalje nga magazina, sipas personave përgjegjës të cilët janë ngarkuar për këtë punë si dhe të atyre që i kanë në përdorim. Për problemet që ekzistojnë për mosfunksionimin e disa aparaturave apo të moskompletimit të tyre të mbahen procesverbalet me firmën që ka bërë montimin.

Në urdhrin e mësipërm nuk përcaktohen konkretisht me emra se cilët janë personat përgjegjës të ngarkuar për këtë punë, pasi nga ana e drejtorit nuk na u paraqit as me observacionet ndonjë urdhër për ngritjen e një komisioni kolaudimi për këto pajisje e aparatura. Gjithashtu në urdhër nuk përcaktohet përgjegjësi për shefat e klinikave.

Edhe pse në urdhrin e sipërpërmendur shprehimisht thuhet se: “Për moszbatimin e këtij urdhëri ndaj personave përgjegjës do të merret masa deri në largim nga puna”, nga ana e drejtuesve të QSUT nuk është marrë asnjë masë administrative apo disiplinore.

Veprimet e mësipërme kanë sjellë si pasojë zvarritjen e marrjes në dorëzim të paisjeve dhe aparaturave si dhe mosevidentimin e mungesave të pretenduara nga shefat e klinikave, duke ngarkuar me përgjegjësi ish-drejtorin e QSUT-së, i cili ka qenë dhe drejtor projekti.

Me shkresën 8/5, datë 22.12.2005 të Ministrisë së Shëndetësisë, me objekt: “Dërgohet kopje e dokumentacionit të Projektit Francez Klinika e Specialiteteve Kirurgjikale pranë QSUT “Nënë Tereza” Tiranë”, bashkangjitur kësaj janë dërguar kopje të katalogëve dhe specifikimeve teknike për pajisjet mjekësore të ofruara nga kompania Itali si dhe procesverbalet e marrjes provizore në dorëzim të objektit.

Në shkresën datë 05.3.2006 (pra 10 muaj nga ardhja e aparaturave, referuar urdhrin të brendshëm nr. 51, datë 23.5.2005) të Klinikës së Specialiteteve drejtuar drejtorisë së QSUT “Nënë Tereza”, nga shefi i shërbimit ORL, shefi i shërbimit okulistik dhe shefi i shërbimit M-Facial, thuhet se: disa nga aparaturat nuk funksionojnë dhe firma që ka realizuar montimin e tyre nuk përgjigjet për t'i riparuar ose mirëmbajtur. Kështu nuk punojnë elektrobisturitë, një aparat anestezie dhe autoklavet njeri nuk funksionon fare dhe tjetri herë punon dhe herë jo, mikroskopi operator i ORL. Njëkohësisht kërkohet që të ndërhyhet nga ana e drejtorisë së QSUT-së pranë firmës që të sillen të gjitha aksesoret që nuk kanë ardhur sipas kontratës. Kërkohet ndërhyrje urgjente, pasi afati i kontratës mbaron në muajin maj 2006.

Në shkresën datë 08.6.2006 të Klinikës së Specialiteteve, drejtuar drejtorisë së QSUT-së “Nënë Tereza” nga shefi i shërbimit ORL-prof., shefi i shërbimit Okulistikë dhe shefi i shërbimit M-Facial, thuhet se disa nga aparaturat nuk funksionojnë dhe se firma që ka realizuar montimin e tyre nuk na përgjigjet për t'i riparuar dhe se autoklavi i vetëm që punonte nuk punon. Gjithashtu në shkresë thuhet se i janë drejtuar Sektorit të Bio Medikalit të QSUT-së dhe ata nuk i janë përgjigjur pasi aparaturat nuk janë të kolauduara nga ata.

Në këtë shkresë nga drejtori i spitalit është vënë shënimi për inxhinieren pranë QSUT-së që të kontaktohet me firmën përkatëse dhe të zgjidhet urgjent ky problem.

Duke iu referuar dy shkresave të Klinikës së Specialiteteve, ku shefat e klinikave kanë ngritur problemin e mosfunksionimit të aparaturave kanë kaluar 13 muaj nga data e nxjerrjes së urdhrin nr. 51 nga ish-drejtori, urdhër në të cilin ish-drejtori kërkon vënien në funksionim të plotë të Spitalit të ri të Specialiteteve.

Për periudhën 13-mujore, grupit të kontrollit nuk iu paraqit asnjë lloj dokumentacioni për mosfunksionimin e aparaturave pas montimit të tyre.

Me shkresën e Bio-Medikalit datë 21.6.2006, drejtuar firmës dhe drejtorit të QSUT-së i kërkohet urgjentisht firmës plotësimi i mangësive në pajisjet dhe aparaturat, probleme të ngritura edhe nga shefat e klinikave.

Me shkresën nr. 2006/39, datë 23.6.2006, firma sqaron se: *aparaturat e sjella nga kjo firmë janë konform specifikimeve të tenderit dhe gjithshka është dorëzuar sipas kushteve të kontratës, për të cilën është marrë dhe miratimi nga konsulenti francez. Gjithashtu në këtë shkresë pretendentohet se firma nuk ka patur dijeni për problemet e ngritura nga shefat e klinikës, deri më datë 20.5.2006, ditë e përfundimit të garancisë.*

Me urdhrin e brendshëm nr. 99, datë 09.10.2006, zëvendësdrejtorja e ekonomike ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës, të përbërë nga 12 anëtarë për pajisjen e aparatrave me kartelën teknike, për çdo aparaturë, ku të specifikohen nr. serisë, prodhuesi, gjendja teknike si dhe stampa e QSUT-së.

Përsa më lart, grupit të kontrollit nuk iu vu në dispozicion asnjë dokument i nxjerrë nga drejtori aktual që nga dita e emërimit, për marrjen në dorëzim të aparatuarave të klinikës së specialiteteve, *duke e ngarkuar me përgjegjësi.*

Me urdhrin e brendshëm nr. 107, datë 18.11.2006, pra pas ballafaqimit të problemeve të dalë nga kontrolli i KLSH, drejtori i përgjithshëm i QSUT-së ka urdhëruar ngritjen e komisionit të inventarizimit të paisjeve mjekësore të instaluar në Spitalin Francez “Klinika e Specialiteteve Kirurgjikale”.

Sipas pikave nr. 1 dhe 2 të këtij urdhri deri me datë 31.12.2006 duhet të bëhej identifikimi në vend i pajisjeve mjekësore, në përdorim apo jo në gjendje pune, në Spitalin Francez, si dhe të bëheshin hyrje këto pajisje, duke i pasqyruar në inventarët përkatës për secilin prej tyre mbi bazën e materialeve të dërguara nga Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria Ekonomike me shkresën nr. 8/5, datë 12.12.2005.

Pra, pas afro një viti nga momenti i ardhjes së dokumentacionit dhe 18-muaj nga momenti i ardhjes së pajisjeve (momenti i ardhjes i referohet vënies në punë të këtij spitali me 30.05.2005, sipas urdhrit të brendshëm nr. 51, datë 23.05.2005, firmosur nga ish-drejtori), për paisjet dhe aparaturat e spitalit me urdhrin nr. 107, datë 18.11.2006, nga ana e drejtorisë së Qendrës Spitalore është bërë inventarizimi i aparatrave të ardhura nga firma “Fortune” s.r.l Itali.

Sipas procesverbalit nr. 1, datë 29.12.2006, të mbajtur nga komisioni i rregjistrimit të pajisjeve të krijuar me urdhrin nr. 107, datë 18.11.2006, rezultojnë se ka aparatura që nuk funksionojnë fare ose funksionojnë me difekt apo kanë mangësi.

Nga komisioni nuk mund të përcaktohet nëse këto aparatura kanë ardhur me difekt apo jo, pasi siç është theksuar më lart nuk është bërë asnjë herë marrja në dorëzim si dhe kolaudimi i aparatrave në momentin e ardhjes.

Nga kontrolli i kryer në fakt, në ambientet e Klinikës Franceze Klauud Bernard, u konstatua se:

Në dhomën e sterilizimit, nga dy autoklava, njera nuk funksionon fare. Që të dyja kanë ardhur jashtë kushteve teknike që në fillim dhe me pjesë mangut si p.sh. kapaku. Gjithashtu, në këtë dhomë nuk funksionojnë tubat e shkarkimit dhe avujt, në vënd që të dalin jashtë qendrojnë brënda.

Gjithashtu në klinikë, aspiratorët kanë ardhur jashtë kushteve teknike dhe me pjesë që iu mungojnë. Njeri nga aparatet e narkozës në dhomën e okulistikës nuk funksionon. Aparati i FAKOS nuk ka funksionuar asnjëherë. Njeri nga aparatet të quajtur FLAUTEK ka ardhur që në fillim i thyer. Në të gjithë ambientet nuk funksionon sistemi i aspirim-ventilimit dhe u konstatua që në sallën e operimit punohej me derë hapur si rezultat i mosaspirimit. Kabina audiometike nuk është montuar saktë dhe si rezultat nuk mbyllet për një funksionim normal. Gjithashtu kësaj kabine i mungojnë dhe aksesore. Gjithashtu për sa i përket pjesës së ndërtimit të godinës u konstatua se muret janë të çara dhe suvaja binte vazhdimisht. Në momentin e parë, sallat kanë qenë pa lavaman dhe vetëm mbas këmbënguljes së personelit janë vendosur lavamanë, por lavamanë plastikë që nuk janë funksionale për një spital. Gjithashtu, dhoma e operimit është me

kartonxhes dhe e pamundur për t'u pastruar. Dyert janë të gjitha prej druri dhe jo metalike siç duhen për një spital në mënyrë që të sigurohet një pastrim dhe higjenë maksimale.

Nga shefi i shërbimit ORL u theksua se asgjë, as aparatat dhe as ndërtesa nuk është marrë asnjëherë në dorëzim dhe me gjithë vërejtjet e shumta që ka patur personeli mjekësor është bërë vetëm një herë një takim me përfaqësuesit e firmës dhe nuk është realizuar asgjë.

Nga ish-kryeinfermieri u theksua se Instituti i Higjenës ka bërë dhe matje për problemin e gazrave si rezultat i mosaspirimit dhe është nxjerrë një shifër mjaft e lartë e ndotjes, por që personelit nuk iu bë asnjëherë e ditur shifra e saktë.

Nga specialisti me detyrë teknik u theksua se:

Aparaturat nuk janë hapur asnjëherë në prezencë të personelit. Akoma stafit teknik nuk i janë vënë në dispozicion katalogët e aparatave. Serveri qendror i cili lidh në rrjet 11 kompjutera në të cilën duhet të regjistrohen të gjithë diagnostikimet, pra është arshiva e Klinikës, nuk i është dorëzuar akoma stafit teknik. Nuk është trajnuar asnjëherë stafi për sa i përket funksionimit të aparatave, duke shkelur kështu edhe marrëveshjen financiare me nr. CAL 1000 01 V, lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim ku një nga komponentët e saj ka qenë dhe trajnimi i personelit mjekësor dhe teknik.

Nga verifikimi i inventarëve fizik dhe kontabël të Drejtorisë së Përgjithshme të QSUT-së, për vitin 2006 u konstatua se:

Lista e pajisjeve të ardhura për Spitalin Francez është në vlerë 1 016 340, 35 euro.

Pajisjet dhe aparatat e spitalit të bëra hyrje në magazinë dhe dalje në datën 29.12.2006, sipas klinikave të specialiteteve janë në vlerë 982 754,4 euro ekuivalente me 124,6 milionë lekë.

Diferenca në vlerën 33 585 euro, ekuivalente me 4,2 milionë lekë përbëhet si vijon:

- Vlera 1 183 euro që i përket zërit B/1.4 të kontratës “stimulator nervash”, për të cilat në momentin e inventarizimit me datë 29.12.2006 pretendohet se nuk janë sjellë nga firma Itali;

- Vlera 2 907 euro, që i përket zërit A/2 të kontratës “instalime”;

Vlera 29 495 euro, që i përket zërit B/1.12 të kontratës “instrumenta kirurgjikale”, për të cilat nuk ishte identifikuar gjendja e tyre deri në momentin e inventarizimit me datë 29.12.2006.

Nga kontrolli i gjendjes kontabël rezultoi se vlera e ndërtesës për Spitalin e Specialiteteve është 3,2 milionë euro, ekuivalente me 403, 6 milionë lekë, vlerë kjo që korrespondon me situacionin përfundimtar të punimeve, ndërsa vlera e pajisjeve dhe aparatave në shumën 124,6 milionë lekë nuk ishte pasqyruar ende në kontabilitet, pasi bilanci ishte në përpunim e sipër.

▪ Për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit u lanë detyra për zbatim.